



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 6 DHJETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 6. DECEMBRA 2012. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2012**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për efikasitetin e energjisë,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

## **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma za finansijsku saradnju između Vlade Republike Kosova i Vlade Republike Austrije,
5. Razmatranje Izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju o nadgledanju sprovođenja Zakona o efikasnosti energije,
6. Razmatranje Predloga - odluke Vlade Republike Kosova o produženju prelaznog perioda za oslobađanje od PDV-a, do 31. decembra 2012. god,
7. Razmatranje Predloga-odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju članova u Bordu Kosovske agencije za privatizaciju,
8. Predlog PG LDK o zameni člana Komisije za nadgledanje javnih finansija.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për diskutime jashtë rendit ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit parlamentar 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replikë nuk ka.

Vazhdojmë! Është mirë të deklarohen deputetët, bile do të ishte mirë të jetë me shkrim nëse është në cilësinë e grupit apo personale. Deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fjalimin do ta filloj me urimin drejtuar gjithë popullit të Kosovës për vendimin e drejtë që e mori Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për lirim të ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Haradinaj, dhe dy komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kjo ishte një ndër lajmet më të mira në këtë nëntor, domethënëse për popullin shqiptar. Me këtë, drejtësia kombëtare edhe një herë vërtetoi se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë dhe e pastër, sepse ishte luftë çlirimtare. Por, me gjithë këtë fakt që drejtësia ndërkombëtare bëri një vlerësim të drejtë për luftën e UÇK-së, disa gjyqtarë të EULEX-it, duke mos i përjashtuar edhe disa gjyqtarë-prokurorë vendorë, në vigjilje të festës kombëtare për të gjithë shqiptarët, nxorën vendimin për paraburgimin e ushtarëve të lirisë, njëherësh deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Limaj dhe tre luftëtarët: Nexhmi Krasniqi, Naser Shala e Naser Krasniqi.

Jam e vetëdijshme që Gjyqësorit vërtet duhet të jetë i pavarur. Kjo pavarësi nuk nënkupton që ata ta keqinterpretojnë dhe ta shkelin ligjin. Në rastin “Limaj”, konsideroj se EULEX-i, jo që ka ndarë drejtësi, por ai e veptoi në të kundërtën. Thjesht, e masakroi drejtësinë para syve të qytetarëve të Kosovës. Unë mendoj se këtij populli dhe këtij vendi vërtet i duhet një Gjyqësor profesional dhe i pavarur. Kërkoj nga EULEX-i dhe nga disa gjyqtarë vendorë të kenë guxim profesional, e të mos ndikohen nga politika ditore e Beogradit, duke i arrestuar çlirimtarët.

Arsyetimi i trupit gjykues se kinse zoti Limaj me shokë mund të shmanget apo të ikën është plotësisht në kundërshtim me vetveten dhe shumë i pavërtetë. Lind pyetja: Si ka mundësi që të ikën zoti Limaj me shokë, kur edhe gjatë luftës, ai me bashkëluftëtarë, e la luksin në Perëndim dhe luftoi kundër pushtuesit, që në këtë vend të funksionojë ligji dhe drejtësia për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Madje, gjykata me asnjë fakt nuk

mund ta bindë as opinionin profesional, e as atë publik se zoti Limaj mund t'u shmanget organeve të drejtësisë, kur i njëjti çdoherë u është përgjigjur me ndërgjegje të gjitha ftesave të organeve gjyqësore. Fakt tjetër është që zoti Limaj ishte në Shqipëri, ku u shpall "Qytetar Nderi i Vlorës", pasi u ftua nga Gjykata, menjëherë u paraqit te organet gjyqësore. Këto fakte të cekura më lart tregojnë se ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare nuk shmangen, nuk ikin nga drejtësia, sepse kanë luftuar për këtë tokë, në mbrojtje të qytetarëve, e jo për të ikur.

Arsyetimi tjetër i Gjykatës se kinse zoti Limaj me shokë po të lihej në liri do të mund të ndikonin te dëshmitarët është...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Unë kërkoja që kush të jetë në emër të Grupit të paraqitet. Regjia, edhe dy minuta, është në emër të grupit.

**HASIME KRASNIQI:** ...i paqëndrueshëm dhe është absurd i llojit të vet. Me këtë rast, u bëjmë thirrje gjyqtarëve vendorë që të punojnë drejt, në mënyrë profesionale, të jenë të guximshëm në aspektin profesional dhe ta tregojnë vërtet pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre si gjyqtarë. Besoj se disa gjyqtarë të EULEX-it nuk e dinë realitetin në Kosovë për të vënë rregull dhe drejtësi, por gjyqtarët dhe prokurorët vendorë nuk duhet të fshihen pas ndërkombëtarëve, se profesionalistët dhe opinionin publik e dinë shumë mirë se sa mund të japin kontribut ata, duke e respektuar pavarësinë e tyre dhe profesionalizmin.

Në fund, në emër të qytetarëve të Komunës së Malishevës, besoj edhe gjithë Kosovës, kërkojmë nga Gjykata Supreme që të jetë e vëmendshme dhe profesionale, duke marrë parasysh kërkesën e palës mbrojtëse për ndërprerjen e paraburgimit. Ne besojmë thellë në pafajësinë e zotit Limaj me shokë, sepse këtë e ka dëshmuar edhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare në Hagë. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Hashim Deshishku. Në emër të vet, a të grupit?

**HASHIM DESHISHKU:** Në emrin tim. I nderuar kryetar i Parlamentit, zoti Krasniqi!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Komuniteti i biznesit me shqetësim të thellë i ka marrë paralajmërimet që vijnë nga Doganat e Kosovës, e që kanë të bëjnë me depot doganore. Sipas tyre, do të mbyllen gati të gjitha depot doganore, të cilat deri më sot i shfrytëzojnë mbi 160 subjekte afariste.

Kjo do të ndodhë duke u bazuar në një arsyetim, i cili është absurd dhe aspak nuk e merr për bazë gjendjen në të cilën gjendet biznesi sot në Kosovë. Zyrtarë nga Dogana e Kosovës kanë deklaruar se disa kompani i kanë shfrytëzuar depot doganore për t'i shtyrë pagesat doganore dhe për këtë arsye do të mbyllen. Kjo deklaratë zyrtare nga Dogana e Kosovës flet qartë për mungesën e organizimit dhe të efikasitetit të saj që t'i zbatojë ligjet apo dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me importin e mallrave. Në fakt, hapja e depove

doganore ka pasur për qëllim që biznesit t'i krijojë lehtësira rreth pagesës së obligimeve fiskale me rastin e importimit të mallrave. Ato janë paguar në momentin kur është shitur malli, do të thotë biznesi nuk është ngarkuar me pagesa përderisa ky mall nuk është shndërruar në para.

Kjo mënyrë e pagesës së obligimeve për importet e realizuara aplikohet në shumë vende të botës, dhe ajo i krijon biznesit lehtësi të madhe, kryesisht për ruajtjen e likuiditetit të kompanive. Po ashtu, kjo formë e pagesës ishte një përparësi e madhe, posaçërisht kur merret parasysh se bizneseve po u mbyllet të gjitha burimet e financimit; ka rënë kreditimi nga bankat, ndërsa kamatat e larta pamundësojnë huazimin e parasë nga bankat komerciale në Kosovë.

Kur e kemi parasysh mënyrën se si funksionojnë depot doganore, disa kompani i paskan shfrytëzuar ato që t'i shtynë pagesat doganore. Bizneset nuk kanë pasur mundësi të sillen në këtë mënyrë, meqenëse zyrtarët doganorë kurdo që kanë dashur kanë mundur ta bëjnë vlerësimin e mallit dhe t'i arkëtojnë obligimet. Do të thotë se bizneset në asnjë mënyrë nuk kanë mundur të sillen jashtë kushteve të parapara për funksionimin e depove doganore. Mirëpo, qëllimi kryesor duket se është diku tjetër. Qeveria, për shkak të shpenzimeve të mëdha, shpesh edhe të paarsyeshme, ka nevojë që sa më parë të vijë deri te paratë. Njëra nga mënyrat është që obligimet doganore të paguhet menjëherë, pa prituri që malli së pari të shitet, e pastaj të mbulohen obligimet. Në këtë mënyrë, ajo synon që paratë t'i fusë në buxhet pa e pasur dert se do të shkatërrohen bizneset kosovare. Ajo po e rrezikon pikërisht burimin kryesor të parasë publike, për shkak të qasjes shumë të gabueshme, por edhe për shkak të rrezikut që po u kërcënohet bizneseve, insistoj që ky vendim, para se të aplikohet, të shqyrtohet edhe një herë. Në fakt, ai nuk duhet marrë fare meqenëse do ta ngufatë biznesin kosovar.

Në anën tjetër, Dogana e Kosovës ka mundësi të shumta që t'i arkëtojë obligimet nga bizneset. Ajo duhet të jetë më aktive dhe të insistojë që Kodi Doganor, si dhe vendimet që kanë të bëjnë me depot doganore të respektohen me përpikëri. Nuk ka asnjë logjikë që për shkak të problemeve që ka buxheti i vendit, zgjidhja të kërkohet në mënyrën më të papranueshme, përkatësisht duke i goditur bizneset kosovare. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën, në emër të grupit, e ka nënkryetari Glauk Konjufca.

**GLAUK KONJUFCA:** Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Këtë javë, opinioni publik dhe qytetarët e Kosovës u tronditën me plot arsye nga një skandal i llojit të vet, në të cilën protagonistë janë figurat më të larta të Qeverisë dhe të PDK-së.

Ajo që e mësoi popullin nga këto biseda të ulëta ishte ajo që dihet nga shumica prej nesh. Dallimi ishte që kësaj radhe u dëgjua nga vetë goja e tyre. Kryeministri i kërkoi llogari shefit të Grupit Parlamentar se a janë duke qëndruar urtë deputetët, kurse ky i fundit, në shkëmbim të servilitetit, e pyet kryeministrin: “A ma ke rehatuar dajën?”. Po të njëjtën ia kërkoi edhe ministres së Integritetit Evropian. Dëgjojmë aty po ashtu që Adem Grabovci i raportoi Kadri Veselit. Në media kemi dëgjuar se ish-shefi i SHIK-ut tash

është vetëm anëtar i thjeshtë i PDK-së. Me të vërtetë e çuditshme! Shefi i Grupit Parlamentar të partisë më të madhe në Kosovë i raporton një anëtar të thjeshtë të partisë për integrimet evropiane dhe për takimet në Bruksel. Por, këto janë gjëra që pak a shumë dihen prej secilit prej nesh.

Qytetarët nuk janë tronditur nga fakti se aty vërtetohet konkretisht mënyra se si punësohen njerëzit në Kosovë, apo se Kosova udhëhiqet realisht nga trekëndëshi Thaçi-Grabovci-Veseli, pra nga shefi politik, nga komandanti i deputetëve robotë dhe nga nëntoka. Këto të gjitha dihen! Por, populli dhe shoqëria jonë u trondit nga diçka tjetër, nga dyfytësia dhe gjuha e pashembullt e komunikimit për nga niveli i perversitetit.

Adem Grabovci i shan me nënë të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe vjen sot në Kuvend e ulet në ulësen e deputetit të Kuvendit pa kokërr marreje. Pastaj, fyhet në mënyrën më degrinuese kryetari i Kuvendit tonë. Ditën na thonë se si kanë respekt për deputetët e opozitës, bile disa prej tyre nga dashuria e madhe që kanë i ftojnë edhe në koalicion bashkëqeverisës, kurse prapa shpinës i shajnë në mënyrat më të gërditshme.

Ditën na thonë që kryeparlamentarin e respektojnë, se ai është sharmi i demokracisë dhe i të menduarit ndryshe, kurse natën shprehen me fjalët më të paturpshme. Krejt ky spektakël i turpit bëhet nga ata që na japin përditë leksione të gjuhës së kulturuar, duke na akuzuar për gjuhë fyese. Dhe, që hipokrizia ta marrë ironinë e saj të plotë, dalin e na thonë se përgjimet janë të paligjshme. Ndërkohë që jo më shumë se para disa javësh, vetë ministri i Punëve të Brendshme personalisht e pranoi se përgjohet Lëvizja “Vetëvendosje”, kurse Prokuroria tha se nuk ka dhënë urdhër për përgjime. Kur po ndodhte kjo, kryeministrit nuk i shkoi ndërmend t’i shkruante zonjës Eshton, tash kur u përgjua vetë po kërcen përpjetë nga mllefi. Pastaj, del kryeministri dhe e akuzon “Vetëvendosjen” se qenka kundër EULEX-it, kundër BE-së, e kështu me radhë. Kurse, menjëherë pas përgjimeve, partia e tij thotë se do t’ia ndërrojë mandatin EULEX-it.

Domethënë, me çdo veprim që bën kjo Qeveri, është Qeveri e përfaqësimit të vetvetes, e jo e mbrojtjes së interesave të qytetarëve dhe të popullit të Kosovës, dhe e mbron vetëm vetveten dhe askënd tjetër. Tash kjo puna e përgjimeve po zhvendoset prej përmbajtjes tyre, te privatësia. Është e vërtetë që të flitet për dajën është privatësi, ama të flasësh me kryeministrin dhe të kërkosh nga ai të ta punësojë dajën në një post që do të paguhet prej parave të qytetarëve, zonja dhe zotërinj, kjo nuk është privatësi. Tek e fundit, edhe nëse është privatësi, le të kapen shkelësit e ligjit, por kjo nuk i heq bash asgjë faktit se prej çfarë njerëzve po qeverisemi.

Tash po e kuptojmë edhe më mirë pse nuk kemi shtet të së drejtës. Sepse kemi njerëz të padrejtë në krye të shtetit. Tash po e kuptojmë pse nuk kemi arsim cilësor. Sepse i kemi njerëzit e paedukuar që organizojnë arsimin në Kosovë. Tash po e kuptojmë pse kemi shëndetësi të mjerueshme. Sepse kemi udhëheqës të sëmurë për pushtet.

Këta njerëz nuk e meritojnë të vendosin asgjë për popullin dhe qytetarët e Kosovës.

KRYETARI: Fjalën, në emër të grupit, e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Krahas problemeve të shumta, të cilat në vazhdimësi po rëndojnë mbi jetën e qytetarit tonë, natyrisht janë edhe shumë çështje të hapura, të pazgjidhura dhe të padefinuara në fushën e arsimit.

Unë sot dua ta ngre zërin për njërën ndër to, që natyrisht gjithnjë e më shumë po bëhet preokupim i njerëzve në përditshmërinë tonë - çështja e kolegjeve private, të cilat po thirren si universitete private. Çështja e kolegjeve të cilat po thirren si universitete private është shqetësim i madh i qytetarëve të Kosovës, sidomos i studentëve dhe prindërve të tyre, që me plot të drejtë vazhdimisht pyesin se si qëndron puna me to. Ndonëse që të gjithë ne e dimë se me ligjet në fuqi nuk kemi universitete private, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Arsimit hesht. Në këtë kuptim, unë pyes se a e meritojnë qytetari ynë, studenti apo prindi këtë heshtje të pakuptimtë, këtë paqartësi me të cilën po përballemi, kush duhet t'u shpjegojë studentëve dhe prindërve, përveçse zyrtarëve institucionalë të Ministrisë së Arsimit. Andaj, pse nuk bëhet kjo?

Nëse Ministria e Arsimit thotë se ligjërisht nuk ka universitete private, e që duhet doemos ta thotë, sepse kjo është e vërteta, atëherë përse ne çdo ditë shohim nëpër Prishtinë autobusë me reklamën "universitete", për shembull "Universiteti AAB"?! Pastaj, si mund të shpjegohen reklamat televizive nëpër mediumet tona për këto kolegje, të cilat paraqiten si universitete private të vendit, madje nëpërmjet figurave shumë të njohura publike të jetës sonë kulturore dhe akademike. A mund të themi se ato përkujnë me realitetin tonë? Natyrisht se jo. Ndaj, dikush duhet ta marrë guximin dhe të veprojë, por kjo do të ndodhë vetëm atëherë kur të lihet më një anë interesat dhe përfitimet marramendëse të njerëzve të caktuar, që vazhdojnë t'i mbrojnë dhe t'i mashtrojnë këto kolegje private, për të cilat unë nuk dua të paragjykoj nëse nesër do të jenë universitete private.

Dikush po del i mashtruar nga gjithë kjo avari që po ndodh para syve tanë për çdo ditë. Dikush duhet të jetë përgjegjës për gjithë këtë gjendje të krijuar. Janë të shumtë prindërit që me pyetjet e tyre të drejtpërdrejta dëshirojnë të marrin një përgjigje: Janë apo nuk janë universitete private? Natyrisht, unë për hir të së vërtetës dhe duke u mbështetur në ligjet në fuqi, nuk mund t'u them tjetër, përveçse "jo, nuk janë". Natyrisht, krahas kësaj, ata marrin edhe përgjigje të tjera, që për hir të së vërtetës duhet thënë se nuk janë të sakta. Prandaj, në këtë mes, Ministria nuk duhet të hezitojë, por ta thotë me guxim e me vendosmëri realitetin në këtë temë shumë të ndjeshme për qytetarët tanë.

Nëse Ministria e Arsimit vërtet ka synimin për ngritjen dhe avancimin e arsimit, këtij segmenti jetik për të sotmen dhe të ardhmen e vendit tonë, atëherë lëvizjet duhet të jenë të menjëhershme dhe të kenë vizion të qartë për avancimin e proceseve të domosdoshme që shpijnë pashmangshëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit, në radhë të parë, dhe mbarëvajtjen e proceseve të tjera dhe në ngritjen e tij.

Një shqetësim tjetër, prapë në lëmin e arsimit, është edhe pamundësia e studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike për vazhdimin e programit të masterit. E gjithë kjo si pasojë e neglizhencës së stafit drejtues të Fakultetit Filozofik, të cilët kinse e kanë vonuar dërgimin e dokumentit për akreditim në Agjencinë për Akreditim. Kështu është thënë në një të përditshme tonën. Pse duhet të pësojnë studentët si pasojë e mosmarrëveshjeve apo defekteve të stafeve udhëheqëse brenda në fakultet? Kush është përgjegjës në këtë padrejtësi për studentët? Kjo nuk do të duhej të ndodhte në asnjë mënyrë, në asnjërin nga fakultetet tona. Këto gjëra jo të mira nuk i ndihmojnë zhvillimit të arsimit në vendin tonë, por përkundrazi e dëmtojnë rëndë procesin arsimor në Kosovë.

Ne mendojmë se ndaj këtyre dukurive, të cilat po e zbehin në masë të madhe procesin e arsimit, nuk duhet të heshtet, por të veprohet urgjentisht në mënyrë që pasojat të jenë sa më të vogla. Çdo vonesë sot në këtë drejtim nesër do të jetë e vonuar dhe në të njëjtën kohë e pajustificueshme dhe joproductive. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të grupit, fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

**SUZAN NOVOBËRDALIU:** Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Unë do të flas për gjendjen e personave me aftësi të kufizuara. Sot gjendja e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk është as për së afërmi në raport me standardet ndërkombëtare. Deri më tani, Kuvendi i Kosovës ka miratuar disa ligje, të cilat prekin çështjet e personave me aftësi të kufizuara.

Kur flasim për ligjet, do të përmend disa prej tyre, të cilat edhe ashtu nuk janë në harmoni me situatën e tyre, por gjithashtu nuk gjejnë zbatim të plotë. Ligji për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, i cili i përfshin të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, nga moshja 18 deri 65 vjeç, me një mbështetje rreth 50 euro, të cilat u jepen në mënyrë lineare pa asnjë dallim apo vlerësim të nevojave të tyre. Ligji është fuqi që nga janari i vitit 2003, por deri më tani nuk po e gjen zbatimin e plotë, meqë për mungesë të akteve nënligjore, nuk po zbatohen beneficionet e parapara.

Ky ligj po ashtu ka shumë mangësi tjera, si p.sh. si mund të quhet pensionist një person i moshës 18-vjeçare, meqë me këtë term humbin të gjitha shpresat e punësimit të tyre. Ky ligj gjithashtu nënkupton që një person me aftësi të kufizuara, kur arrin të gjejë punë, ai menjëherë largohet nga kjo asistencë materiale, e cila edhe ashtu as për së afërmi nuk i mbulon nevojat e tij.

Këtu duhet të përmendim një grup të personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë më të rrezikuarit në mesin e personave të tillë. Personat me lëndime të boshtit kurrizor, para dhe tetraplegjikët, të cilët për arsye të mostrajtit të tyre të duhur shëndetësor dhe rehabilitues, mungesës së njësisë spinale, mungesës së përkrahjes financiare nga institucionet tona, për të siguruar medikamentet dhe pajisjet e nevojshme ditore, të cilat janë më se të domosdoshme për jetën e tyre, meqë vetëm nga viti 2009 e deri më tani, 15 persona nga ta kanë vdekur nga plagët dekapitare, infeksionet e ndryshme të veshkave dhe ato urinare.



Duhet përmendur se ky numër është në rritje si pasojë e aksidenteve dhe lëndimeve të ndryshme që mund të pësojë çdokush. Kjo çështje duhet të rregullohet me ligj të veçantë, ashtu sikur që është e rregulluar me ligj në Shqipëri dhe vende tjera.

Ligji tjetër, përkrahja materiale për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, përfshirë fëmijët e moshës 1-18 vjet, të cilët marrin nga 100 euro. Këtu mungon mbështetja për asistentët, personat e tyre, si dhe pasi fëmijët të kalojnë në moshën 9-10-vjeçare, ata marrin vetëm 50 euro. Ky përgjysmim i pagesës është i pakuptimtë, kur kemi parasysh se nevojat rriten, kurse aftësia e kufizuar është e përhershme.

Çështjet tjera që janë më se të nevojshme që të intervenohet dhe që janë shqetësuese janë: integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla, vetëm 11%; mungon një strategji mbi çështjet e personave me aftësi të kufizuara; nuk dihet numri i saktë i personave me aftësi të kufizuara; asnjëherë nuk është bërë asnjë hulumtim nga institucionet tona në lidhje me llojet e aftësisë së kufizuar, gjendjen, nevojat dhe të drejtat e tyre në raport me parimet të Kushtetutës së vendit dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara.

Edhe pse është krijuar Këshilli i Aftësisë së Kufizuar qysh nga viti 2006, ai nuk funksionon. Mungon një zyrë për çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel të Zyrës së Kryeministrit, e cila do t'i shërbente si sekretariat këshillit të lartpërmendur. Mungon një ligj, i cili do t'i mbulonte personat me aftësi të kufizuara me pajisje, karroca, paterica, aparate higjieniko-sanitare, aparate të dëgjimit dhe pajisje të tjera.

Ata deri më tani janë mbuluar vetëm nga OJQ-të. Mungon Ligji për asistencë personale, në mungesë të të cilit i detyron familjarët të largohen edhe nga puna, vetëm që të kujdesen për anëtarët e tyre.

Urdhëresa administrative 2007/33, kushtet teknike për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objektet publike, nuk zbatohet fare. Kjo çon në përjashtimin e njerëzve me aftësi të kufizuara nga pjesëmarrja e tyre në jetën publike. Duhet përmendur që kufizimi apo pamundësia e një personi që të ketë qasje të lirë konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut. Edhe Kuvendi, meqë ne jemi tempulli i demokracisë, nuk ka qasje për persona me aftësi të kufizuara.

Ligji për aftësim e riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara nuk zbatohet fare. Në këtë drejtim, Qeveria, Kuvendi i Kosovës, përkatësisht ministritë e lindjes, duhet të bëjnë zbatimin e plotë të ligjeve aktuale që rregullojnë çështjet e personave me aftësi të kufizuara, Qeveria t'i rishikojë të gjitha ligjet që prekin çështjet e personave me aftësi të kufizuara dhe ato të harmonizohen me ligjet e vendeve të Bashkimit Evropian, derisa Komisioni Funkcional i Kuvendit të mbikëqyrë zbatimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja të cilën do ta shtroj sot, është nevoja imediate e qytetarëve të kryeqytetit tonë për vend parking të automjeteve. Të gjithë jemi dëshmitarë që qyteti i Prishtinës është ngulfatur nga automjetet, të cilat, në mungesë të vendit adekuat për parkim, parkohen nëpër trotuare dhe vende të tjera, ku parkimi është i ndaluar. Në këtë mënyrë e pengojnë shumë lëvizjen e lirë dhe të sigurt të qytetarëve, nxënësve, të fëmijëve, pleqve dhe të gjithë atyre që gjenden ose e vizitojnë Prishtinën.

Këto ditë kemi dëgjuar nga mediet që një grup qytetarësh në shenjë revolte të zënies së trotuareve nga veturat, kanë shkruar afishe “Ju parkoni, ne i gërvishtim!”. Këtë gjest, që nuk dihet konkretisht nga kush është organizuar, unë personalisht e shoh të papranueshëm dhe jodemokratik, të cilin e dënoj ashpër. Por, në anën tjetër, bëj apel te Komuna e Prishtinës dhe te të gjitha institucionet relevante, që sa më shpejt të gjejnë lokacione dhe mjete financiare për parkingje të automjeteve, në mënyrë që qytetarët e kryeqytetit të mos bëjnë vepra të pahijshme dhe qyteti i Prishtinës të ketë një pamje, që u ngjason qyteteve evropiane.

Ne e dimë se Komuna është duke bërë rregullimin e një parkingu te Qendra Klinike Universitare. Mendoj që është lokacion i mirë, por është stërzgatur vënia e tij në funksion. Kryeqytetit i nevojiten edhe vende tjera parkingu, si në afërsi të qendrës, e po ashtu në hyrje të çdo magjistraleje në qytet, me ngritjen e të cilave Prishtina do të frymonte më lirshëm.

Shpresoj që kësaj çështjeje do t’i kushtohet rëndësi e veçantë, se tek e fundit kryeqyteti është i të gjithë neve dhe është pasqyra e vendit, në sytë e secilit që vjen ta vizitojë Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola ta marr fjalën sot, për të shprehur shqetësimet lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin e sigurisë dhe në sektorin e jetës publike.

Sa i përket sektorit të sigurisë, ju e dini se elementi i parë i sigurisë dhe identitetit të qytetarëve të Kosovës, kohëve të fundit ka dalë informacioni dhe realisht situata është e tillë që pasaporta e qytetarëve të Kosovës është e inkriminuar deri në atë masë, sa për të është kërkuar edhe ryshfet dhe kompanitë ndërkombëtare tashmë janë deklaruar dhe pozicionuar dhe njerëzit janë në burg.

Para kësaj, ka pasur një aferë tjetër, që ka qenë afëra me arin, i cili është vjedhur në Pejë. E para saj ka qenë afëra tjetër, që ka të bëjë me vjedhjen e Dhomës së Dëshmive dhe shumë fakte tjera të rëndësishme, të cilat bëjnë që qytetarët e Kosovës të ndihen të pasigurt.

Mirëpo, kjo nuk është tema kryesore për të cilën do të flas. Do të flas për një temë, e cila është bërë temë diskutimi në mediet e Kosovës dhe, po ashtu, temë diskutimi për qytetarët e Kosovës. Është tema lidhur me aferën e përgjimeve.

Afera e përgjimeve ka qenë një aferë, për të cilën unë personalisht dua ta përgëzoj medien e Kosovës për guximin që e ka shfaqur me publikimin e përgjimeve, sepse është tentuar që të thuhet se këto përgjime e kanë shkelur privatësinë dhe se janë në kundërshtim me ligjin.

Unë nuk mendoj se e kanë shkelur privatësinë, sepse me sa kam parë dhe dëgjuar unë, aty nuk flitet për diçka private. Mendoj, se ne të gjithë jemi persona publikë dhe në momentin kur jemi të tillë, mbajmë përgjegjësi për ato që themi, përderisa nuk bëhet fjalë për gjëra strikt private familjare.

Një element, i cili do të duhej të merrej në konsideratë, nëse është i ligjshëm apo i paligjshëm përgjimi, është çështje tjetër. Se a kanë shkruar përgjimet në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme në duart e medievet, edhe kjo është çështje tjetër. Mirëpo, media si e tillë e ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe dërgimin e informacionit te publiku. Unë mendoj se media e ka bërë punën e vet dhe mendoj se nuk e ka shkelur privatësinë. Ajo çka u dëgjua aty, është një çështje tjetër. Unë nuk kam dal të vlerësoj se çka është dëgjuar aty, sepse të gjithë e kemi dëgjuar dhe e kemi parë, kemi shprehur indinjatën dhe pakënaqësinë tonë. Bile, unë personalisht kam shprehur indinjatën dhe solidaritetin deri diku me kryetarin e Kuvendit, por çështja është: A kemi të bëjmë me privatësi, apo nuk kemi të bëjmë me privatësi?

Unë mendoj se kur flitet për jetën publike, kur flitet për institucionet publike, kur flitet për vendimmarrje, kur flitet për çfarëdolloj forme të komunikimit, që ka të bëjë me interesin publik, kjo nuk ka privatësi.

Privatësi do të ishte, në qoftë se ndokush nga personat e përgjuar, tashmë në mënyrë të ligjshme...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri.

**VISAR YMERI:** Faleminderit kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Kur nisi ky proces i negociatave, që po quhet politik, ai u proklamua shumë si proces, në të cilin çështjet prioritare do të jetë çështja e të pagjeturve dhe ajo e strukturave ilegale të Serbisë.

Kjo, të paktën thuhej nga Hashim Thaçi, i cili këto çështje i vlerësonte të jenë prioritet në agjendën e tij të bisedimeve.

Ai thoshte se ky proces negociatash do të rezultojë me zgjidhjen përfundimtare të këtyre dy çështjeve. Në njëërën anë, do të kthehen të gjithë trupat e shqiptarëve të vrarë e të rrëmbyer nga Serbia gjatë luftës së fundit, ndërkohë që strukturat ilegale e kriminale të Serbisë, të cilat veprojnë të papenguara në Kosovë, do të shpërbëhen tërësisht.

Çështja e të pagjeturve asnjëherë nuk ka qenë temë e këtyre bisedimeve. As në këtë takim të tretë, asgjë nuk thuhet për këtë. Në komunikatën zyrtare të ndërmjetësueses së dialogut, lëshuar nga zyra e baroneshës Eshton, të pagjeturit nuk përmenden fare.

Ndërkohë, sa u përket strukturave ilegale, në këtë takim thuhet se palët e kanë arritur pajtimin që t'i shqyrtojnë mënyrat e rritjes së transparencës së qarkullimit të parasë që vjen nga Serbia për serbët e Kosovës, para këto që vijnë në Kosovë edhe nëpërmjet strukturave ilegale, por edhe për strukturat ilegale të Serbisë.

Pra, pranohen strukturat dhe kërkohet thjesht transparencë në financimin e tyre. Secili qytetar i Kosovës e di se këto financohen nga Serbia. Problemi nuk është te transparenca e financimit të strukturave ilegale, por te prania e tyre në Kosovë dhe dhunimi i përditshëm, që këto struktura ua bëjnë shqiptarëve, pronës private, pronës publike dhe shtetit të Kosovës.

Thaçi nuk po e lufton këtë dhunim, por nëpërmjet bisedimeve po kërkon që ky të bëhet i dukshëm, pra të bëhet transparent.

Thaçi me bashkëpunëtorin e tij, Daçiq, po ashtu janë dakorduar që të fillojë zbatimi i Marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Në këtë takim ata janë dakorduar edhe për ndarjen e parasë publike të Kosovës. Edhe pse nuk është thënë zyrtarisht, duket se marrëveshja është që mallrat që hyjnë në Kosovë të mos doganohen në kufirin verior me Serbinë, por në terminalin doganor, i cili gjendet në Mitrovicë.

Ndërkohë është përmendur mundësia që serbët, që jetojnë në veri, të jenë të liruar nga taksat doganore. Po ashtu, është raportuar se një përqindje e TVSH-së së mbledhur t'u shkojë strukturave serbe në veri. Nëse kjo është marrëveshja, atëherë i bie që tash strukturat ilegale të Serbisë të financohen edhe nga paraja publike, që është dashur të jetë pjesë e Buxhetit, apo e hyrë në Buxhetin e Kosovës.

Për më tepër, kur një pjesë e territorit lirohet nga një tatim i caktuar, e në këtë rast taksa doganore, atëherë kjo pjesë e territorit merrtribute tjera prej pjesëve tjera të territorit, merr veçantinë e vet territoriale jashtë rregullave të përgjithshme shtetërore të pjesës tjetër të vendit. Kjo është pra autonomia. Ta ndash veriun e vendit nga sistemi fiskal i Kosovës nënkupton se ua ke lënë strukturave atje ta përcaktojnë sistemin e vet fiskal, duke e pasur parasysh se atje strukturat politike janë të Serbisë, kjo i bie që sistemi fiskal atje do të jetë i Serbisë. Pra, që kufiri realisht po zhvendoset në lumin Ibër.

Negociatat e tilla joparimore dhe pa kurrfarë kushti për Serbinë dhe me strukturat ilegale të saj, të armato....

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Koha e paraparë për deklarime jashtë rendit të ditës për sot u krye.

Më falni, ministri i Arsimit e pati kërkuar fjalën. Nuk është këtu. Ministri i Financave, zoti Bedri Hamza e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

U ngre çështja e depove doganore. Deputetë të nderuar, ju në vazhdimësi jeni duke aprovuar ligje, të cilat kanë për qëllim lehtësira për biznesin, krijimin e një ambienti më të favorshëm për biznesin.

Depot doganore janë të lejuara me ligj. Nuk ka asnjë vendim për mbylljen e tyre. Të gjithë ata, që në bazë të ligjit e kanë fituar këtë të drejtë, mund të vazhdojnë ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, por të gjithë ata të cilët nuk janë duke e respektuar ligjin, sigurisht se nuk mund të vazhdojnë ta fitojnë këtë të drejtë. Problemi qëndron në faktin se disa tatimpagues, të cilët e kanë fituar të drejtën në bazë të Ligjit për depot doganore, e kanë dallimin ndërmjet gjendjes kontabël dhe gjendjes faktike.

Dhe, në momentin kur i kanë shitur mallrat dhe në përputhje me ligjin duhet t'i paguajnë obligimet e tyre për doganë dhe TVSH. Ata vazhdojnë të mos i paguajnë obligimet e tyre, vazhdojnë që paratë të cilat janë të ndara për shtetin, në këtë rast dogana dhe TVSH-ja, është normal që është e dëshirueshme për biznesin të mos shkojë në bankë të marrë kredi e overdraft, e çështje tjera, mirëpo shtetit duhet paguar taksat.

Prandaj, Ministria e Financave nuk ka kërkesë, nuk ka vendim për t'i mbyllur depot doganore, të cilat funksionojnë duke e respektuar ligjin. Kërkesë jona e vetme është që të zbatohet ligji dhe të gjithë ata tatimpagues, të cilët nuk e kanë zbatuar ligjin, sigurisht se ligji i sanksionon. Faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Ministri i Arsimit, Buja e ka fjalën.

**MINISTRI RAMË BUJA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë dola për të sqaruar për opinionin më shumë, se sa për deputetët, sepse deputetët e dinë, siç e di edhe deputetja në fjalë, se është biseduar jo një herë por dhjetëra herë këtu në këtë Kuvend, se nuk ka universitete private dhe pikë. Është qartësuar kjo dhe ju e keni vendosur këtë me ligjin, që e keni aprovuar në këtë Kuvend.

Dhe, unë nuk e di, habitem, sinqerisht, se si shtrohet kjo çështje. Se kush duhet të ndër marrë diçka për t'i penguar këto, për të nxjerrë reklama andej e këndeje?! Ne si

Ministri e Arsimit e kemi dërguar inspektoratin në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, që e kanë keqpërdorur këtë emër të tyre. Dhe, tani është në procedurë penalizmi i tyre, sepse në fakt e kanë shkelur ligjin. Por, të thuhet se kush, e si, e çka..., unë po ju them një gjë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e ka nisur procedurën e amendamentimit të Ligjit për arsimin e lartë, për faktin se ka gjëra shumë të paqarta në të.

Ju e dini sa shpejt atëherë e aprova atë ligj, sepse, për shembull, për institucionet e arsimit të lartë thotë: “Institucioni i caktuar duhet të ketë pesë doktorantë, që nxjerr nga vetvetja, 5 mijë studentë” e tjera. E po, nuk akreditohet në asnjë mënyrë, te asnjëri institucion, ta zëmë, doktorata. Si t’i nxjerrë tre doktorantë? Duhet të qartësohet kjo punë dhe shumëçka tjetër në ligj dhe unë besoj që kjo do të ndodhë, për një procedurë që është normale, por të shtrohet këtu se “pse, pse, pse, ka apo s’ka universitete private”, kjo është e qartë. Në Kosovë nuk ka universitet privat! Janë tri publike. E a do t’i bëjmë, a s’do t’i bëjmë, do të jetë përsëri çështje e ligjit, a e amendamenti ju, se a do ta hapni portën, apo do ta lini mbyllur, siç është tani. Edhe 20 vjet, asnjë institucion në Kosovë, me këto që janë në ligjin e shkruar, nuk mund të bëhet universitet, as që mund të emërtohet.

Kështu që, ta sqaroj opinionin, e jo deputeten, sepse ajo i di, sepse është edhe anëtare e Komisionit për Arsim, Shkencë e të tjera.

Dhe, çështja e magjistrantëve, që nuk i vazhdojnë ligjëratat. Unë do të marr informacione dhe pastaj do të ju sjell këto informacione, nëse është e nevojshme, po ajo është çështje e Universitetit Publik të Prishtinës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

**SABRI HAMITI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar,

Për çështjen që u shtrua nga një kolege deputete dhe nga ministri i Arsimit, megjithatë, unë i dëgjova kujdesshëm dhe duhet një shpjegim.

Ligji për arsimin nuk i pengon universitetet private. Me ligjin në fuqi, mund të ketë universitete private. Nuk ka universitete private, për shkak se asnjëra nga institucionet e arsimit të lartë nuk e ka arritur nivelin që të quhen të tilla dhe të akreditohen të tilla. Prandaj, ne e kemi një seri kolegësh universitare, të cilat e kanë arritur nivelin e kërkimeve, të organizimit të numrit të studentëve, të kualitetit të programeve, që të quhen të tilla. E tash është problem krejt tjetër në shoqërinë tonë çfarë ndodh. Pse këto i ndjellin, i kërkojnë kandidatët e vet, sikur kur njeriu del në pazar duke u lavdëruar.

Më në fund shikoni, puna e reklamave është se gjithmonë, ose shpeshherë reklamohen prodhimet që nuk janë të mira, se ato që janë të mira e kanë nivelin e pranuar qytetarë dhe s’duan shumë reklama. Kjo nuk është sferë e Ministrisë së Arsimit, sepse është mënyra qysh i kërkojnë njerëzit.

Problemi i Ministrisë së Arsimit është që të mos pranojë diploma të paakredituara, që të saktësohet që këto e këto programe në filan kolegji universitar janë të akredituara dhe kanë barasvlershmëri me diplomat publike.

Edhe një herë: nuk është problem që ligji aktual i pengon, por nuk ka nivel të studimeve, deri në nivel doktrate, asnjë kolegji universitar deri sot. Dhe, ajo varet prej fuqisë së tyre, prej organizimit të tyre. Nuk varet as prej ministrit, as prej ligjit.

Edhe prindërit, meqë po thotë prindërit... Shikoni, nuk janë kaq analfabetë studentët, që e kanë kryer një shkollë të mesme, sa të mos dinë të flasin, të kërkojnë vetë, e t'u dërgojmë ne "të fala" nëpërmjet kësaj foltoreje, a kanë të drejtë të regjistrohen. Ata janë studentë fillestarë dhe e dinë shumë mirë çka u duhet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Të interesuar të tjerë më ka më, as nga Qeveria, as nga deputetët.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Për këtë seancë janë parashtruar 12 pyetje parlamentare. Koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Pyetjet që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit.

Fillojmë me deputeten e parë, deputetja Vjosa Osmani, pyetje për kryeministrin Thaçi. Deputete, do ta shtrosh pyetjen? Në seancën tjetër. E njëjta deputete ka pyetje edhe për ministrin e Punëve të Jashtme. Edhe këtë e lë për seancën tjetër. Mirë!

Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Mahir Jagxhëllar. Deputete, do ta bësh pyetjen?

**KYMETE BYTYÇI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Zoti ministër, duke pasur parasysh faktin se me legjislacionin në fuqi është përcaktuar që çdo i pesëdhjeti person i punësuar duhet të jetë person me aftësi të kufizuara, kërkoj që të më njoftoni se sa është numri dhe përqindja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Administratën Publike, respektivisht në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës?

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

**KRYESUESI:** Zoti ministër!

**MAHIR JAGCILAR:** I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 10 të Rregullores për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrave, dhe nenin 38 paragrafi 36 të Rregullores për Punën e Qeverisë, si dhe dispozitat e Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike, duke u bazuar në këto dispozita ligjore, nuk ka ndonjë obligim që të mbajë evidencë për çështjen, e cila është kërkuar në pyetjen e parashtruar.

Por, sidoqoftë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me udhëzimin për mënyrën dhe rregullat e mbajtjes së evidencës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ka rregulluar dhe përcaktuar kushtet për mbajtjen e evidencës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara, e cila është përcaktuar në Ligjin për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Në këtë udhëzim administrativ, përveç tjerash, është rregulluar përgjegjësia e zyrave të punësimit, për mbajtjen e administrimit të evidencave për të punësuarit me aftësi të kufizuara, të cilëve këto evidenca u dërgohen nga punëdhënësi. Ky udhëzim e ka rregulluar edhe përmbajtjen e këtyre evidencave. Në këtë aspekt, këto çështje nuk janë rregulluar sa i përket Administratës Publike në mënyrë të përcaktimit dhe çështjes së evidencës.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Bytyçi?

**KYMETE BYTYÇI:** Zoti ministër, tek unë, po ashtu edhe në takimet e Komisionit Parlamentar, kanë ardhur shumë ankesa, si nga individë, po ashtu edhe nga OJQ, që deklarojnë se as për së afërmi nuk janë plotësuar këto kritere, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë publik. Kjo tregon, se juve si Qeveri, nuk ju bën përshtypje kjo kategori e qytetarëve të Kosovës. Andaj, zoti ministër, kërkoj që ta respektoni dhe ta zbatoni ligjin.

**KRYESUESI:** Zoti ministër!

**MAHIR JAGCILAR:** Faleminderit! Ligji i shërbimit civil është aprovuar në këtë Parlament në mandatin e kaluar, por besojmë që me plotësimin dhe ndryshimin në ligj, sepse ne iniciuam si ministri që për vitin e ardhshëm të bëhet ndryshim dhe plotësimi i Ligjit për shërbimin civil. Besojmë që bashkërisht këto çështje do t'i rregullojmë, sepse janë me interes të veçantë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ju kisha lutur për qetësi. Gjatë sqarimit, që ka bërë ministri, 26 deputetë kanë folur ndërmjet tyre. Prandaj, nuk është mirë të mos e respektojmë atë që do të na sqarojë.

Zoti Goran Marinković, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

**GORAN MARINKOVIĆ:** Hvala, predsedavajući!  
Poštovani ministre,



Poštovani poslanici,

Na osnovu podataka i statistika, aa... izvinjavam se, to je pitanje za Nanada Rašića.

I posle veoma velikih zamerki, koje smo kao poslanici srpske nacionalnosti upućivali, a tiču se natpisa koji obeležavaju imena mesta, koje su prefarbana crnom bojom na srpskom jeziku, a na nekim mestima i promenom imena mesta, nije se dovoljno uradilo kako bi se stanje promenilo, a putokazi i natpisi mesta doveli u ustavnu i zakonsku formu.

Moramo biti iskreni i reći da se ipak nešto uradilo, i da se taj problem jedino rešilo u Prištini, kao glavnom gradu. Ali da li je Priština celokupno Kosovo i da li se zakon jedino tu mora poštovati?

Pitanje: Kada će ministarstvo rešiti problem da se putokazi i saobraćajni znakovi, koji su prefarbani crnom bojom zamene na celoj teritoriji Kosova, kao bi odavali multietnički karakter zemlji u kojoj živimo?

KRYESUESI: Zoti ministër Mujota!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Marinković,

Mbishkrimet e vendbanimeve në tabelat informuese në rrugët publike, si autostradë, rrugë nacionale dhe regjionale, bëhen nga kompanitë profesionale projektuese, sipas projektit të sinjalizimit dhe ligjeve në fuqi. Këtu përfshihen madje edhe të gjithë udhëtreguesit, informatat turistike, parqet nacionale e tjerë.

Dëmtimi, ngjyrosja dhe mbulimi me ngjyrë të zezë të tabelave informuese në vendbanime, të tabelave treguese në drejtim të rrugëve, udhëtreguesve, e tjerë, bëhen nga individë dhe grupe të papërgjegjshme gjithkund në Kosovë. Ministria e Infrastrukturës nuk mund t'i parandalojë ato, mirëpo për këtë bashkëpunon me Policinë e Kosovës, e cila i heton dhe i ndjek këto raste sipas ligjit.

Tabelat, për informimin tuaj dhe të publikut, dëmtohen, vidhen dhe mbulojnë në të gjitha rajonet e Kosovës dhe në të gjitha gjuhët, që janë në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës.

Ministria e Infrastrukturës çdo vit, sipas planit vjetor, ndan rreth 1 milion euro buxhet për sinjalizim, për shenjat vertikale, horizontale, për portale, për semaforët dhe për vijat në rrugë. Po bëjmë gjithçka që të bashkëpunojmë me policinë e komunikacionit, me Inspektoratin e Ministrisë dhe inspektoratet komunale që t'i parandalojmë dëmtimet, por ne nuk kemi mundësi që dëmtimet e qëllimshme t'i eliminojmë në tërësi, pa ndihmën e të gjithë mekanizmave dhe qytetarëve të vendit dhe për të mos thënë edhe pa ngritjen e kulturës për komunikacionin.

Për shembull, vetëm këtë vit, sa për informimin tuaj, ne pesë herë me radhë i kemi vendosur barrierat në rrugën nacionale Prishtinë-Pejë dhe sërish ka tendenca të dëmtimit të tyre, e me të po rrezikohet jeta e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po kështu, javë më parë janë prerë të gjitha shenjat në një pjesë të komunës së Shtërpcës, me të cilat janë thurur madje pronat dhe oborret e qytetarëve. E, kjo tregon për nivel të përgjegjësisë dhe jo ndërgjegjes në raport me shenjat e komunikacionit në rrugë. Kjo, gjithashtu, të ju informoj se e ka një kosto të lartë dhe është jashtë mundësive tona buxhetore për t'i evituar të gjitha dëmtimet që shkaktohen në secilën periudhë kohore.

Megjithatë, ne u apelojmë edhe në këtë rast të gjithë qytetarëve të vendit, që të mos i dëmtojnë shenjat dhe emërtimet në rrugët tona, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve tanë, ndikon në jetën tonë. Prandaj, bëjmë thirrje që të mos i dëmtojnë ato dhe njëkohësisht do të merren të gjitha masat sipas ligjit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, që ata njerëz të pandërgjegjshëm të paraqiten para ligjit dhe të japin përgjegjësi.

Po ashtu, ne jemi të përkushtuar që në bashkëpunim me të gjithë aktorët, të gjithë qytetarët dhe të gjitha institucionet e vendit, t'i mbrojmë të gjitha aspektet kushtetuese dhe ligjore për përdorimin e gjuhës dhe mbishkrimet në të gjitha rrugët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Marinković? Zoti Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući.

Gospodine ministre,

Znamo da je vreme stabilizacije, da nema para, da nedovoljno postoji svest građana. Koliko vi možete da utičete na vežeće kompanije, koje su u ovom trenutku, a koje rade i koje se bave zamenom znakova, i da li ste uopšte pokušali, ako se sećate ja sam isto pitanje postavio pre gotovo godinu dana, i posle toga samo se u Prištini nešto promenilo. Da li možete nešto konkretno da nam kažete poslanicima, kada ćete vi da utičete na kompanije kao ministarstvo, i da se ti znakovi barem još jednom zamene, a onda da se utiče na svest građana da se to ne radi?

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI, FEHMI MUJOTA: I nderuar deputet,

Sërish e kuptoj shqetësimin tuaj dhe natyrisht kërkesën që e shtron në drejtim të Ministrisë së Infrastrukturës, por është e pamundur që të kërkohet me dhjetëra herë brenda vitit nga kompanitë që të sjellin shenja të reja dhe sinjalistikë të re, sepse kjo është e pamundur të ndodhë në kuptimin buxhetor.

Megjithatë, për informimin tuaj dhe të publikut, është ajo se ekziston një model shumë i përparuar, të cilin në të ardhmen do ta kemi parasysh dhe do ta prezantojmë edhe me kërkesë buxhetore shtesë për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që të paktën mbishkrimet të mos mund të dëmtohen. Ndërsa çështja e dëmtimit, vjedhjes apo keqpërdorimit tjetër të shenjave, vërtet do të jetë një çështje që do të jetë në diskutim të

gjatë dhe derisa të mos ketë përmirësim të vetëdijes dhe kulturës në komunikacion, vështirë është të evitohen këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Rashiq.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Na osnovu podataka i statistika, nivo nezaposlenosti na teritoriji celog Kosova je procentualno visok, a naročito u novoformiranim opštinama, tako da moram da izrazim svoju zabrinutost kada je u pitanju održivo zapošljavanje u opštinama, gde su srbi većinski zastupljeni.

Projekti koji imaju za cilj zapošljavanje nisu brojni, a njihov broj mora biti povećan sa naglaskom “na novoformiranoj opštini”, koja imaju limitirane kapacitete zapošljavanja. Prema saznanjima koje imam, Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu tokom 2012. godine je realizovala program javnih radova u saradnji sa opštinama na Kosovu, i koje se sada implementira.

Moje pitanje, uvaženi gospodine ministre, glasi: Koje opštine su dobile projekte, koliko su ti projekti uticali na sniženje nezaposlenosti na nivou Kosova, a posebno kod manjinskih zajednica?

KRYESUESI: Zoti Rashiq, e keni fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Gospodine Marinkoviću,

Zahvaljujem se na pitanju, jer mi smo u zadnjih nekoliko godina uradili dosta na povećanju kapaciteta svih tih novih opština. Kao što znate, mi smo bili u obavezi da pre svega, u novim opštinama izgradimo infrastrukturu, odnosno da svaka nova opština ima centar za socijalni rad, a u centru za socijalni rad da bude deo i kancelarija za zapošljavanje.

Mi smo to već uradili, skoro u svim opštinama, od Gračanice, Junika, na kraju do Parteša i Klokota, koje se završavaju ove godine. Tako da završno sa ovom godinom, mi ćemo imati u svim novo otvorenim opštinama svoje kancelarije za zapošljavanje.

Što se tiče projekata, koje ste pomenuli, ja moram da naglasim da jedna stvarno podrška, koja je na zavidnom nivou što se tiče novih opština jeste na snazi, to jest mi smo ove godine samo 2012. godine, preko projekta javnih radova, negde 20% je finansijskih sredstava od tih projekata bilo usmereno u novoformirane opštine, a od toga od same radne snage negde 22% ljudi je bilo iz nevećinskih zajednica.

Prema tome, u samom projektu javni radovi, ili takozvani projekat “održivo zapošljavanje”, koji je bio implementiran, ove godine je bilo upotrebljeno 477 hiljada

evra, iz tog jednog projekta, koji mi finansiramo, a u saradnji zajedno sa Evropskom Komisijom imamo drugi projekat, takozvani "Lepo Kosovo", ili "Beautiful Kosovo", koje je takođe imalo jedan određeni udeo, od negde 280 hiljada evra utrošeno u tom projektu. Tako da u ova oba projekta je bilo utrošeno negde 750 hiljadu evra samo za ovu godinu. U projektu "Lepo Kosovo", do kraja godine biće započeta je još dva projekta. Na proleće sledeće godine, imaćemo dodatnih još tri, plus uključujućih 5 poslednjih projekata, koji će biti finansirana na severu Kosova, odnosno severno od reke Ibar.

U ovim projektima za ovu godinu smo imali samo o projektima, održao zapošljavanje, je bilo 45 ukupnih projekata, i malte ne skoro su sve opštine učestvovala u tom implementiranju, kad je zaposleno ukupno 223 osoba, ljudi ne većinske zajednice, odnosno ne albanaca. Od ukupnog broja svih zaposlenih, negde 22% ukupnog broja radne snage, što znači da svi ti ljudi koji sam pomenuo i te brojke koje sam rekao su uključeni u projekte, koji su 3 do 6 meseci trajanja, i oni su u tim projekta plaćaju u iznosu od 200 do 270 eura. To je samo...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Edhe një minutë ministrit!

**MINISTRI NENAD RAŠIĆ:** ...u ovoj godini. Projekat se već implementira tri godine i biće planiran i za sledeću godinu. Ja mislim da je taj jedan dobar broj, dobar početak i sigurno ćemo i u buduće nastaviti da radimo na ovakve projekte. Hvala!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit! Ka pyetje shtesë, zoti Marinković?

**GORAN MARINKOVIĆ:** Imam samo konstataciju. Nemam pitanje, pošto Ministarstvo dobro radi, druga pitanja nemam. Nadam se da će da nastavi s'tim projektima.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit!

Deputetja Vjollca Krasniqi, pyetje për zëvendëskryeministrin Kuçi. Zëvendëskryeministri nuk është këtu, sipas informacionit që e kam zoti Jagxhëllar është i ngarkuar për t'u përgjigjur. A dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Krasniqi e ka fjalën.

**VJOLLCA KRASNIQI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po e bëjë këtë pyetje, edhe pse nuk është zëvendëskryeministri këtu, sepse në pyetjen time e kam apostrofuat edhe ministrin Çeku. Kështu, para disa ditësh ia kam bërë një pyetje zotëri Çekut, mirëpo nuk kam marrë përgjigje. Ka të bëjë me çështjen e gjendjes së kazermave ushtarake të ish-TMK-së, e tash disa të shfrytëzuara nga FSK-ja, mirëpo disa kanë mbetur nën mëshirën e kohës, të cilat janë demoluara, janë degraduar, janë shkatërruar plotësisht.

Pyetja ka qenë atëherë, zotëri ministër, për kazermën ushtarake "Zahir Pajaziti" në Llukar, e cila është demoluara krejtësisht dhe mendoj që këto objekte nuk do të duhej lënë kësisoj. Agjencitë e ndryshme, që sot paguajnë qira për objektet që i shfrytëzojnë, kanë

mundur t'i shfrytëzojnë këto objekte deri në një vendim të ardhshëm të Kuvendit për dedikimin e tyre.

Pyetja tjetër është: Objekti që gjendet afër hotelit "Grand", ish-objekt i APJ-së, tash i shfrytëzuar nga EULEX-i, pronë e kujt është, sepse sipas shënimeve kadastrale, kjo pronë ende është e ish-pronarëve, ish-pronarëve të paraluftës dhe sipas informacioneve, EULEX-i është shfrytëzues, ndërsa qiradhënës është UNMIK-u. Si mund të jetë UNMIK-u qiradhënës i një objekti që nuk është i tij?

KRYESUESI: Zoti Jagxhëllar, përgjigjen për çka je i ngarkuar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete, faktikisht janë dy pyetje, por unë do të përpqiem t'i përgjigjem pyetjes konkrete, sa i përket objektit që gjendet afër hotelit "Grand", tash i shfrytëzuar nga EULEX-i, se pronë e kujt është dhe kush është qiradhënës.

Ministria e Administratës Publike, faktikisht në vitin 2009, si Ministri e Shërbimeve Publike, e ka lidhur memorandumën për mirëkuptim me Agjencinë e Privatizimit, në bazë të të cilit Ministria e Administratës Publike i ka marrë në menaxhim objektet që kanë qenë në shfrytëzim nga TMK-ja, e të cilat kanë qenë pronë shoqërore. Ndërsa, sa u përket objekteve që kanë qenë pronë shtetërore si të tilla, disa nga këto prona janë menaxhuar nga UNMIK-u, e më vonë i janë transferuar EULEX-it, konkretisht ndërtesa ku tash është ndërtesa qendrore e EULEX-it, ose ish ndërtesa e Armatës.

Në lidhje me objektin, i cili gjendet afër hotelit "Grand", ky objekt ose faktikisht kompleks, ka qenë në shfrytëzim nga UNMIK-u, pastaj të njëjtin UNMIK-u e ka transferuar te EULEX-i, ndërsa ne si Qeveri dhe Ministri e Administratës Publike gjithmonë kemi kërkuar ta marrim në menaxhim dhe gjatë bisedimeve edhe marrëveshjeve, deri tash e kemi marrë pjesën ku ka qenë ish-hoteli dhe ndërtesa është duke u rinovuar dhe së shpejti Ministria e Punëve të Jashtme do të akomodohet aty. Ndërsa dy objektet tjera ende janë në menaxhimin e UNMIK-ut, ndërkaq shfrytëzohen nga EULEX-i, por ne edhe më tutje jemi duke kërkuar që këto t'i transferohen Qeverisë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje shtesë për zotin Jagxhëllar? Jo, në rregull. Zoti Çeku, dëshironi të vazhdoni? Shiko, na e ke ngatërruar pyetjen me dy persona këtu, kështu që nuk ke qenë...

*(Reagime nga zonja Krasniqi)*

Qeveria ia ka dhënë, unë nuk ia kam dhënë. Atëherë, vazhdojmë. A ke pyetje shtesë? Vazhdo.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit!

Me të vërtetë, nuk e plotësoi kjo përgjigje atë çka do të donim të na thuhet në këtë përgjigje. Objekti është i menaxhuar nga EULEX-i, por pronë e kujt është? EULEX-i nuk është lindur dhe rritur këtu, prandaj nuk mund të jetë pronë e EULEX-it dhe ne të marrim leje prej EULEX-it për ta menaxhuar këtë objekt, e jo vetëm këtë, por edhe një numër të objekteve të tjera të ngjashme me këtë.

**KRYESUESI:** Zoti ministër, vazhdo. Ju faleminderit!

**MINISTRI MAHIR YAGCILAR:** Faleminderit! Unë shpjegova për pjesën e hotelit që në marrëveshje me UNMIK-un e kemi marrë në menaxhim dhe së shpejti në të do të akomodohet Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa për pjesën tjetër ende jemi në bisedime dhe në negociata që ta transferojmë. Në atë ndërtesë tash për tash gjendet EULEX-i.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Çeku, a dëshiron ta plotësosh përgjigjen?

**MINISTRI AGIM ÇEKU:** Faleminderit!

Ditën kur e keni bërë pyetjen kam qenë jashtë vendit, kështu që kërkoj ndjesë, ngase nuk kam qenë i pranishëm këtu, por sa u përket objekteve që i përmendët - Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, për aq vjet sa kanë vepruar, i kanë pasur në shfrytëzim 40 objekte të ndryshme. Në të gjitha këto objekte është investuar shumë, të gjitha kanë qenë të pastruara pas luftës, kanë investuar vetë ushtarët e TMK-së, është investuar nga buxheti i TMK-së, por edhe nga donacionet e ndryshme, kryesisht nga shoqata "Miq të TMK-së". Fatkeqësisht, me transformimin e TMK-së në FSK, ashtu siç ka qenë e imponuar edhe vetë struktura, roli, misioni i FSK-së, kanë qenë të imponuara edhe vendqëndrimet e FSK-së dhe krejt FSK-ja është vendosur në 8 vendqëndrime. Dhe, pas këtij vendimi, drejtuesit e TMK-së i kanë dorëzuar të gjitha objektet: 5 objekte ia kanë dorëzuar Ministrisë të Shërbimeve Publike. Këto 5 objekte si pronë shtetërore, pronë e ish-ushtresë jugosllave, i janë dorëzuar Ministrisë të Shërbimeve Publike, me marrëveshje dhe me datë të caktuar, nga e cila kalojnë të saj. 27 objekte tjera, të cilat kanë qenë pronë shoqërore, i janë dorëzuar gjithashtu me procesverbal, me memorandum bashkëpunimi, Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Tani unë mendoj se ndoshta, të mos keqkuptohem, ka qenë një vendim i gabuar, që është pranuar, sepse është dashur, ngase dihet se jo çdo herë Kosova do t'i ketë 2 500 ushtarë, por shumë shpejt do të ketë ushtarë aq sa ka nevojë. Tani jemi në proces të rishikimit të FSK-së. Pjesë e këtij procesi është edhe vendvendosja e njësive në të ardhmen dhe, unë mund të them, edhe ministri le ta dijë, që do të kemi kërkesa konkrete që disa nga objektet që kanë qenë në shfrytëzim të TMK-së dhe sot janë në menaxhim të Ministrisë së Administratës Publike, apo Agjencisë Kosovare të Privatizimit, t'i kthehen FSK-së, apo Ushtrisë së Kosovës në vitin e ardhshëm. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kuçi. Zëvendëskryeministri nuk është këtu. Zonja Haxhiu, e ka fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Për këtë seancë kam parashtruar dy pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Të dyja pyetjet lidhen me skandalet e fundit të përgjimeve të zyrtarëve të lartë. E para ka të bëjë që më 29 nëntor 2012, Qeveria e Kosovës deklaroi se publikimi i përgjimeve të tilla të fabrikuar me qëllim të shantazhimit të personaliteteve institucionale dhe jetës së tyre private, është vepër e kundërligjshme dhe e dënueshme. Po atë ditë, EULEX-i konfirmoi se ato janë të vërteta.

Pyetja është se cila është përgjigjja e Qeverisë? A janë të vërteta ato çfarë thuhet në incizimet që i dëgjoi opinioni publik?

Pyetja e dytë ka të bëjë me projektligjin për përgjimet, pra me kë e ka konsultuar Projektligjin për përgjimet Ministria e Drejtësisë, i cili ligj u miratua në mbledhjen e Qeverisë më 3 dhjetor 2012, kur është hartuar ai dhe cilët aktorë të shoqërisë civile apo cilët ekspertë kanë qenë të përfshirë në atë projektligj? Unë e pres përgjigjen në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Domethënë të dy pyetjet i kreve përnjëherë. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë i kam dy pyetje për ministrin. Meqenëse nuk është këtu, vetëm po i lexoj pyetjet, me shpresë që në seancën e ardhshme të jepet përgjigjja.

Pyetja e parë ka të bëjë me Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 6 shtator të vitit 2012, e cila kërkon që të zëvendësohen kodet telefonike aktuale në Kosovë me kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë, pra me kodin telefonik 355. Pyetja ka të bëjë me atë se a kanë nisur negociatat, meqë u bënë 3 muaj që kur është nxjerrë kjo rezolutë. A kanë nisur negociatat dhe nëse po, në ç'pikë janë, e nëse jo, pse nuk kanë filluar?

Ndërkohë pyetja e dytë lidhet me procesin e privatizimit të rrjetit të Distribucionit dhe Furnizimit me energji elektrike. Është deklaruar publikisht se borxhin e mëhershëm të qytetarëve ndaj KEK-ut do ta mbledhë konsorciumi "Limak&Çalik". Pyetja ime është se në ç'mënyrë dhe sa është përqindja që t'i takojë për këtë mbledhje të borxhit dhe cila është baza ligjore që është vendosur për këtë mënyrë të trajtimit të borxhit publik, meqenëse e dimë se ky borxh i takon korporatës publike, ato para që nuk janë paguar për energjinë elektrike do të duhej t'i takonin asaj, e jo një konsorciumi, i cili po e privatizon tash rrjetin. Pra, këto janë ato dy pyetje që i kam pasur për ministrin.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albana Fetoshi, pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari-Lila.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë me 5 raste për lëshimin e licencave të subjekteve afariste, të cilat janë nënshkruar nga ministrja, apo janë lëshuar nga MTI-ja në periudhën kohore kur ajo nuk ka qenë në këtë pozitë, dhe pyetja e dytë po ashtu ka të bëjë me licencat, meq; ka ndodhur nënshkrimi i tyre licencave për vitin 2011, ndërkohë që ka pasur edhe 7 vendime tjera, të cilat kanë qenë nga vitit 2010. A mund të na japë shpjegime ministrja, pse është bërë ky favorizim i disa subjekteve afariste duke i dëmtuar disa subjekte tjera që presin një kohë të gjatë marrjen e këtyre licencave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuara deputete,

Ju faleminderit për pyetjen. Ju e keni parashtruar një pyetje me dy nënpyetje për të gjeturat e Auditorit. Komenti për pjesën e parë, përkatësisht për të gjeturën e parë të Auditorit të Përgjithshëm është si vijon: Procesi i dhënies së licencave subjekteve gjatë vitit 2012 është zhvilluar në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ numër 7/2010, neni 8. Përmbajtja e licencës: çdo licencë e lëshuar përmban të gjitha elementet e nevojshme, e një ndër to edhe numrin rendor dhe datën e lëshimit. Të pesë rastet të cilat ju i përmendni, në të gjeturat e Auditorit i kanë plotësuar kushtet për licencë subjekteve afariste për importin e naftës, shitjes me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të saj, raste këto të periudhës kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e kishte të zbrazët pozitën e ministrit, domethënë prej tetorit 2010 deri në shkurt të vitit 2011.

Me ta marrë detyrën, të ligja lëndët, përkatësisht vendimet në pritje për nënshkrim të licencave janë kthyer për rishikim në zyrën për licencim, rregullim-vëzhgim të sektorit të naftës. Pesë prej këtyre lëndëve i kanë plotësuar kushtet për nënshkrim, ndërsa për të tjerat është sugjeruar të plotësohen. Një ndër vërejtjet në lëndët e kthyera ka qenë se nuk i kanë plotësuar kushtet konform Udhëzimit Administrativ nr. 7/2010, neni 4.4, ku thuhet: “Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës duhet të jetë në origjinal, ose kopje të vërtetuara anë gjykatë, ose në organin kompetent”.

Kjo është sa i përket pjesës së parë. Sa i përket pjesës së dytë, është se çdo subjekt afarist që i plotëson kushtet për dhënie të licencës, konform Ligjit nr. 03/138 dhe Udhëzimit Administrativ 7/2010, ne i kemi licencuar dhe lëshuar në afatin e caktuar. Çdo subjekt afarist që i ka plotësuar kushtet për marrje të licencës nuk guxon të jetë peng i subjekteve afariste që kanë aplikuar më parë dhe nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara ligjore dhe e njëjta vlen edhe për rastet, të cilat ju i keni cekur.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Fjalën deputetes Fetoshi!

ALBANA FETOSHI: Sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011, ministre këtu thuhet që 7 prej atyre rasteve nuk janë marrë fare në shqyrtim, domethënë janë anashkaluar dhe janë favorizuar subjektet afariste, të cilave jua keni dhënë licencën.



Këtu, te raporti i Auditorit, po e cek vetëm një rast - ata kishin vazhduar me nënshkrimin e licencave për vendimet e marra për vitin 2011, siç ishte rasti me licencën nr. 588 51, sipas vendimit të datës 5.5.2011, kurse ato të vitit 2010 akoma ishin në pritje. Mendoj se vonesat e tilla ndikojnë në favorizimin e disa subjekteve afariste, duke i dëmtuar subjektet tjera që presin një kohë të gjatë për marrjen e licencave. Pra, kjo nuk ka të bëjë me faktin se disa subjekte afariste i paskan plotësuar kriteret e disa jo. Mund të ketë edhe aso raste kur disa i plotësojnë e disa jo, mirëpo ne kemi të bëjmë me rastin kur disa subjekte afariste janë anashkaluar, domethënë ka pasur raste prej vitit 2010 dhe nuk janë shqyrtuar ende. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit! Zonja ministre!

**MINISTRJA MIMOZA-KUSARI:** Ju faleminderit, deputete!

Të njëjtin sqarim ne ia kemi dhënë edhe Auditorit Gjeneral, që rastet që kanë qenë në pritje janë rastet që nuk e kanë sjellë dokumentin e plotësuar dhe të gjitha ato kompani kanë mbetur në pritje, por nuk kemi dashur t'i lëmë të gjitha në listë të presin për arsye se disa nuk i kanë plotësuar me kohë. Prandaj, i njëjti koment i është dhënë Auditorit të Përgjithshëm. Sa apo pse, nuk është marrë parasysh. Është çështje e tyre tërësisht. Megjithatë, te ne nuk ka rast kur kompania anashkalohet me dokumentacion të plotësuar. Çdo kompanie me dokumentacion të plotësuar i nënshkruhet licenca pa asnjë problem. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministren Çitaku. Ministrja nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Në seancën tjetër. Mirë.

Të gjitha pyetjen janë shteruar. Para se të kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën për një çështje.

**ISMET BEQIRI:** Zoti kryesues!

Vërtet ju kërkoj falje, edhe deputetëve. Të falënderoj që ma dhatë fjalën, por vërtet atë që e shtroi deputetja Krasniqi është pyetje me vend, por nuk mori përgjigje. Unë ju lus, ne jemi edhe para opinionit. Nuk mund shfrytëzuesi t'ia japë në shfrytëzim dikujt tjetër një pronë që nuk është e tij. Prandaj, me këtë çështje duhet në mënyrë serioze të merren institucionet tona. As nuk dihen kah shkojnë ato para. Më falni, por cili UNMIK tash t'i marrë paratë, e EULEX-i në këtë rast qiramarrës!

Prandaj, ajo është pronë e Kosovës, është pronë jona dhe vërtet, mua më vjen keq, është gjynah, mëkat, ta maltretojmë zotin Jagxhëllar, sepse as nuk e ka pyetur kush, as nuk e pyet asgjë për atë punë, por, sinqerisht, Qeveria jonë, Qeveria e Kosovës, duhet të merret me këtë punë dhe nuk mund me një pronë, që është pronë e Kosovës, edhe një herë po e them - nuk dihet kah shkojnë ato para, e i merr ati i cili nuk është kompetent, në këtë rast UNMIK-u. Ne e dimë që me heqjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, çfarë roli i ka mbetur UNMIK-ut. Ne e dimë që EULEX-i dhe KFOR-i janë të pranishëm dhe institucionet tona. Nuk ka të tjera.

Prandaj, me cilën bazë, mbi cilën të drejtë UNMIK-u e lëshon në shfrytëzim atë objekt që nuk është i tij. Aty flitet sigurisht edhe për shumën të mëdha të parave. Pse ato para të mos shkojnë në Buxhetin e Kosovës dhe të përdoren për nevojat e qytetarëve edhe për nevojat e institucioneve tona. Prandaj, vërtet është shqetësuese dhe me këtë punë duhet të merremi, e jo vetëm kalimthi të jepet një përgjigje çfarë ishte kjo që sot që e dëgjuam. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Edhe deputetët kur t'i bëjnë pyetjet duhet t'i shtrojnë dhe t'i marrin përgjigjet konform pyetjeve, e jo ta shmangin edhe Ministrinë, edhe pyetjen. E drejta për ta kërkuar një çështje dhe për të bërë debat është e të gjithëve dhe unë ju kisha preferuar më shumë që për këto çështje të zhvillohet debat, të konsultohen ligjet, të shihen marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Qeverisë, UNMIK-ut, EULEX-it. Të gjitha këto mund të marrin informacion nëpërmjet një debati, e jo brenda dy minutave, sepse askush nuk besoj se do të jetë i kënaqur me asnjë lloj përgjigje për këtë çështje.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 15 dhe 16 e 22 nëntor të vitit 2012**

Të nderuar deputetë dhe deputete,  
Pyes nëse keni vërejtje në këto procesverbale. A ka dikush ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 15 dhe 16 e 22 nëntor 2012.

Pika e katërt e rendit të ditës:

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë**

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Bedri Hamza si propozues i çështjes që ta marrë fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Ministria e Financave e ka nënshkruar një marrëveshje kornizë për bashkëpunim financiar me Austrinë, e cila ka për qëllim zgjerimin e bashkëpunimit financiar ndërmjet

dy vendeve, në veçanti duke mbështetur projekte specifike nëpërmjet kredive të buta të rifinancuara nga Banka austriake sipas skemës së financimit eksportues të saj për projektet e interesit të ndërsjellë në Republikën e Kosovës.

Termat dhe kushtet e kredive do të vendosen në pajtim me obligimet ndërkombëtare, në veçanti marrëveshja për kredi eksportuese, të mbështetura zyrtarisht sipas kushteve të favorshme të organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim, OECD-e. Pjesë e marrëveshjes janë sektorët e privilegjuar për projekte, në të cilat do të financohet nëpërmjet kredive të buta, pas përgatitjes së projekteve specifike në sektorët e bujqësisë, ujërave të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të zeza, shëndetësisë, trajtimit të mbeturinave, arsimit dhe trajtimit profesional, fushat e infrastrukturës, mbrojtjes civile dhe e-qeverisjes. Si pjesë e marrëveshjes, një kornizë financiare indikative prej 20 milionë euro është parashikuar për një periudhë prej dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje për të gjitha projektet që do të financohen.

Kreditë do të jenë me kushte shumë të volitshme dhe me një periudhë afatgjate të kthimit të tyre. Duke e konsideruar këtë marrëveshje si mënyrë të mirë për financim në fushën e bujqësisë, sektori i ujërave të pijshëm dhe ujërave të zeza, i shëndetësisë, sektori i trajtimit të mbeturinave arsimit dhe trajtimit profesional, fushat e infrastrukturës, të mbrojtjes civile dhe e-qeverisjes, rekomandoj që Kuvendi ta miratojë Projektligjin e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Sipas radhës, kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, ku ka qenë i pranishëm edhe ministri, i cili u është përgjigjur disa kërkesave, të cilat janë shtruar në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka vlerësuar si pozitive këtë marrëveshje dhe e ka miratuar dhe ka rekomanduar që edhe Kuvendi ta miratojë. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje për bashkëpunim financiar, do të zbatohen projekte të rëndësishme zhvillimore dhe bashkëpunimi financiar ndërmjet dy vendeve, në fusha të cilat janë të përcaktuar në marrëveshje dhe ne kemi konsideruar që janë fusha apo sektorë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Propozimi i projekteve që do të financohen përmes kredive të buta, do të bëhet pas përgatitjes së projekteve specifike dhe fusha të cilat nuk dua t'i përmend se i tha edhe ministri.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka vlerësuar investimin në këto fusha dhe ka vlerësuar si të rëndësishëm që këto investime të përmirësojnë gjendjen në këta sektorë. Kredia është 100% kredi e butë, me terma afatgjate të kthimit dhe me një greis-periudhë,

prandaj ne e kemi vlerësuar si pozitive, e kemi përkrahur dhe rekomandojmë që ta përkrahin edhe deputetët.

Nëse më lejohet isha deklaruar edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ne në Grupin Parlamentar e kemi shqyrtuar këtë projektligj për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje dhe rekomandojmë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që të miratohet edhe në seancë plenare.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pra, tash është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Osmani e ka fjalën.

**NASER OSMANI:** Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi shqyrtuar dhe kemi ardhur në përfundim që marrëveshjet, të cilat janë të favorshme, marrëveshje që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, sidomos në sektorët e veçantë, do t'i përkrahim.

Meqenëse ka të bëjë me një kredi të butë, kredi domethënë që është shumë e favorshme, sepse ka një kamatë prej 0,4 apo 0%, me periudha shumë të përshtatshme për Kosovën, ju përkrahim.

Ajo çka ne më tepër na intereson është që të krijohen raporte të reja, raporte të interesave mes dy shteteve dhe do të dëshironim që këto projekte të shkojnë në sektorë atje ku Kosova ka nevojë dhe ku ajo nuk mund krejtësisht me buxhetin e vet t'i financojë dhe është më se e domosdoshme që të merren këto kredi.

Ajo tjetra që na inkurajon është se Austria njihet si një vend me një blegtori dhe bujqësi të zhvilluar dhe 50% e kësaj shume do të shkojë me produkte që burojnë, që e kanë prejardhjen nga shteti i Austrisë. Domethënë do të futemi në produkte të kualitetit të mirë në Kosovë.

Atë që do të dëshironim që të kemi informacione më të mira si deputetë, të jenë projektet më të specifikuar. Për shembull në bujqësi, për çfarë çështje në bujqësi, në shëndetësi, në arsim apo në trajnime të jenë më të specifikuar. Për shembull është e shkruar që fusha e bujqësisë, për shembull sistemi i ujitjes. Pra, sistemi i ujitjes a mund të jetë sistemi i ujitjes? Mirëpo, në përgjithësi ne e përkrahim dhe do ta votojmë meqenëse është marrëveshje që duhet të ratifikohet me 2/3 e deputetëve dhe unë mendoj që këto marrëveshje kur të pajtohemi në komisionet dhe grupet parlamentare gjatë votimit nuk duhet të dështojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Fetoshi.

**ALBANA FETOSHI:** Faleminderit kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje”, në parim e mbështet Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar mes vendit tonë dhe Qeverisë Austriake.

Mendojmë se kushtet e financimit të ofruara nga ana e Qeverisë Austriake përmes sistemit të tyre bankar janë tejet të volitshme dhe mund të ndihmojnë në iniciimin apo forcimin e aktiviteteve ekonomike brenda vendit.

Në të njëjtën kohë mendojmë se projektligji i paraqitur në Kuvend për miratim do të duhej të plotësohej me disa elemente shtesë që do të mundësonin përdorimin më efikas të mjeteve financiare. Është qëndrimi yni që në projektligj, për shembull, duhet të shtohet edhe një nen që do ta caktonte shumën maksimale për financimin e projekteve individuale, shumë kjo e cila do të mund të ndryshonte në varësi të sektorit që financohet.

Ndërkaq sa i përket vetë marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve, për atë sa është e arritshme, Lëvizja “Vetëvendosje” sugjeron që të modifikohet lista e sektorëve që parashihen të mbështeten nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.

Meqë marrëveshja lejon financim deri në 50% të shpenzimeve për blerje jashtë Republikës së Austrisë, atëherë mendojmë se duhet të financohen kryesisht ata sektorë, të cilët do të mund të gjeneronin deri 50%, apo një proporcion të konsiderueshëm të tij brenda Kosovës.

Njëkohësisht, me synim të përdorimit të kësaj mbështetjeje financiare sa më shumë në funksion të forcimit të rritjes ekonomike të vendit, sugjerojmë që marrëveshja të fokusohet në ato fusha ekonomike, ku më fuqishëm përfaqësohet sektori privat.

Marrëveshja ekzistuese kryesisht parasheh financimin e projekteve publike, andaj mendojmë se Qeveria e Kosovës do të duhej ta përgatiste një material përcjellës, ku do të specifikoheshin hapësirat për përfitim edhe në sektorin privat.

Kjo do t'i zvogëlonte edhe mundësitë për keqpërdorime eventuale nga sektori publik, keqpërdorime që do ta vështirësonin në të ardhmen nënshkrimin e marrëveshjeve të ngjashme edhe me vendet tjera mike.

Kjo është me rëndësi meqë dihet se mbështetja financiare e ofruar mund të jetë e leverdishme vetëm kur u ofrohet qeverive të përgjegjshme, por mund t'i dëmtojë seriozisht interesat ekonomike të vendit kur mbështetjet e tilla merren dhe shfrytëzohen nga qeveri inkompetente dhe të korruptuara.

Si rrjedhojë, sugjerojmë që spektri i projekteve të pranuar ta përjashtojë fushën e infrastrukturës, të mbrojtjes civile dhe të e-qeverisjes.

Krejt në fund, sugjerojmë që neni 5 i marrëveshjes të precizojë që për shuma më të mëdha se 100 000 euro apo ndonjë shumë tjetër të dakorduar të pamundësohet kontraktimi i drejtpërdrejtë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,  
Ministra dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe shpresojmë që këto kredi do t'i sjellin një zhvillim ekonomik vendit, do të gjenerohen vende të reja të punës, por kemi disa sugjerime që projektet të cilat do të dorëzohen, duhet të jenë të analizuara mirë, të jenë konkretisht të caktuara për ato vende të cilat do të sjellin një zhvillim më të shpejtë ekonomik, do të ketë rritje ekonomike dhe rritje të vendeve të punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh gjendjen në të cilën gjendet shteti i ri i Kosovës dhe duke marrë parasysh se shumë projekte nuk mund të realizohen vetëm nga Buxheti i Kosovës, atëherë Koalicioni për Kosovë të Re, përkrah Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Duke marrë parasysh se kemi nevojë edhe për kredi të buta për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe shumë projekte të cilat mund të realizohen mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë austriake, si në sektorin e bujqësisë, ujërave të pijshëm, ujërave të zeza, trajtimit të mbeturinave, arsimit, fushës së infrastrukturës, mbrojtjes civile e qeverisjes dhe duke marrë parasysh se këto janë kredi afatgjata, Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah projektligjin dhe shpreson që në të ardhmen të gjitha projektet që do të realizohen brenda këtij ratifikimi të kësaj marrëveshjeje, do t'i sjellin të mira qytetarëve të Kosovës. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, zonja Bale!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nacrt zakona koji ima za cilj ratifikaciju Okvirnog sporazuma o finansijskoj saradnji između Vlade Republike Kosova i Vlade Republike Austrije u cilju realizacije razvojnih projekata u oblastima koji su utvrđene sporazumom, Parlamentarna grupa “6+” podržava, jer smatra vrlo korisnim i značajnim pomoć Austrijske vlade u pružanju kredita po povoljnim uslovima, kao i to da indikativni finansijski okvir iznosi 20 miliona evra, predviđen za period od 2 godine, od momenta stupanja ovog zakona na snagu.

Parlamentarna Grupa “6+” podržaje ovaj zakon.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas diskutimeve që janë bërë në emër të grupeve parlamentare, të gjithë janë për ta miratuar. Në sallë janë 85 deputetë. E dini se sipas Rregullores duhet të jenë 80 vota, të paktën, për t'u miratuar si ligj. Jemi duke pritur për një minutë të vijnë edhe deputetë tjerë.

Ju lus, zini vendet dhe do të votojmë.

Në sallë janë 93 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj se me 87 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunimin financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Pika e pestë e rendit të ditës:

### **5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë**

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbikëqyruar zbatimin e ligjit numër 04/L-0116 për eficiencën e energjisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Tash është radha e diskutuesve. Sipas Rregullores, fjalën e ka fjalën kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Zoti nënkryetar,

Në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, ju prezantoj punën që e ka bërë ky komision në monitorimin e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë elektrike.

Më lejoni që para se t'i lexoj rekomandimet të ju njoftoj që Grupi Punues, i emëruar nga Komisioni, me raportuesin zotin Ymeri, i ka bërë disa aktivitete në kuadër të këtij monitorimi, që kanë të bëjnë me kontakte të ndryshme të cilat janë bërë me institucionet përkatëse, me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me KEK-un, me komuna të ndryshme, me institucione tjera, me grupe të interesit. Ka pasur dëgjim publik edhe debat brenda komisionit, ka pasur një prezantim, i cili ka rezultuar me disa rekomandime, të cilat unanimisht janë pranuar nga komisioni.

Më lejoni që të ju lexoj rekomandimet në mënyrë që edhe anëtarët tjerë të Komisionit në fjalët e veta t'i shpalosin edhe detajet tjera për sa i përket nxjerrjes së këtyre rekomandimeve dhe të punës që ka rezultuar me këtë rast.

Të miratohen rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë elektrike, si në vijim.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në strategjinë legislative për vitin 2013, plotësim-ndryshimin e Ligjit për eficiencën e energjisë;
2. Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të nxjerrin akte të nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji në afatin prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;

3. Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të ndajë buxhet të mjaftueshëm për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve me aplikim të masave efieciënce dhe të jetë më efektive në përfitimin e fondeve publike nga institucionet e jashtme për investime në fushën e efieciëncës së energjisë, e po ashtu Ministria të ketë prioritet ngritjen e kapaciteteve administrative të Agjencisë së Kosovës për Efieciëncën e Energjisë.
4. Agjencia e Kosovës për Efieciëncën e Energjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të ndërmarrin fushata vetëdijesuese për rëndësinë e efieciëncës së energjisë me karakter afatgjatë në mënyrë që të shtohen aktivitetet në fushën e edukimit dhe vetëdijesimit;
5. Komunat të hartojnë planet e tyre për efieciëncën e energjisë në mënyrë që të jenë më konkurruese në përfitimin e fondeve të jashtme, të destinuara për efieciëncën e energjisë, në afatin prej 6 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve;
6. Të thellohet bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë së Kosovës për Efieciëncën e Energjisë dhe komunave.

Dhe, më lejoni po ashtu që krejt në fund të prezantimit të këtyre rekomandimeve, meqenëse gjatë procesit të monitorimit kemi identifikuar edhe një numër institucioneve dhe agjencish edhe të vendit edhe të huaja që merren me këtë çështje, t'i falënderojmë të gjithë ata dhe t'i inkurajojmë po ashtu që në punën e tyre të vazhdueshme në mbështetje të institucioneve dhe të qytetarëve të punojnë dhe investojnë edhe më shumë në fushën e efieciëncës së energjisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e çmon shumë angazhimin e Grupit punues, përkatësisht të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, që ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për efieciëncë të energjisë.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve është të dihet se sa po zbatohen këto ligje, ku janë pengesat, ku janë mangësitë dhe ku janë dobësitë në mënyrë që të bëjmë ligje sa më të mira, që janë në favor edhe të qytetarëve tanë.

Prandaj, edhe mbikëqyrja e këtij ligji ishte të vlerësohet edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik se sa po zbaton, përkatësisht sa po i përmbush detyrimet që dalin nga ky ligj, cilat janë pengesat, mangësitë e ligjit në fjalë, identifikimi i problemeve për moszbatim dhe më tutje që t'i rekomandohet të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji.

Kemi hasur gjatë monitorimit se sa po zbatohet ky ligj, gjatë vizitave në teren, kontakteve me asociacione të ndryshme, kemi hasur se në konfliktin me ligjin për vetëqeverisjen lokale. Pjesa e Ligjit për planet e efieciëncës në nivel lokal është një pikë e diskutueshme e ligjit, pasi që bie në konflikt me ligjin për qeverisjen lokale. Kjo bën që vullneti për krijimin e zyrave komunale të vijë te komunat.



Ne si Grup Parlamentar mendojmë që duhet të ndryshohet në këtë pikë ligji dhe do ta diskutojmë më tutje kur Qeveria ta bie për plotësim e ndryshim se a duhet të jenë zyra komunale apo duhet të jenë zyrtarë komunalë, meqenëse ka implikime buxhetore dhe dihet se është shumë e kufizuar përfshirja e stafit më të gjerë në këtë drejtim.

Mandej, mospërfshirja e sektorit privat, ligji nuk e përfshin, nuk e rregullon fare sektorin privat dhe dihen rrethanat në Kosovë se pse nuk përfshihet sektori privat, sepse janë disa kritere të cilat duhet t'i përmbushin edhe sektori publik edhe privat, mirëpo kjo është me rëndësi të përfshihet në ligj më tutje ky sektor dhe është një komponentë kyçe për implementimin e masave të efijencës.

Ligji po ashtu nuk parasheh marrjen e masave për vetëdijesimin dhe edukimin e qytetarëve për rëndësinë e efijencës, që kjo është një pikë shumë e rëndësishme që duhet të vetëdijesohen qytetarët në përgjithësi për rëndësinë e efijencës. Mandej nga ky monitorim që mos ta zgjas më tepër, sigurisht do të elaborojë edhe udhëheqësi i Grupit punues i këtij ligji, nevojat për ndryshim dhe plotësim të ligjit, ky ligj duhet të ndryshohet dhe plotësohet, sepse do të qartësonte krijimin e zyrave, përkatësisht zyrtarëve, të përfshijë masa konkrete për rritjen e efijencës që janë të cekura në planin e veprimit, të kërkojë auditimin e sistemeve të ngrohjes e klimatizimit, të detyrojë aplikimin e fushatave për promovimin e përdorimit efijent të energjisë dhe të lë hapësirë për zhvillimin e akteve nënligjore të cilat duhet të përmbajnë detale të këtyre politikave.

Në ligjin e amendamentuar, që mendohet ta sjellë Qeveria në vitin e ardhshëm kalendarik, duhet të ofrohen masa stimuluese për përdoruesit efijent të energjisë, si dhe të specifikohen afatet kohore të implementimit të tij.

Sektorit privat duhet t'i jepet rëndësi e veçantë, duke i definuar kompanitë e mëdha që janë konsumues të mëdhenj të energjisë dhe t'u ofrohet lirim nga taksa dhe çmime të favorshme të energjisë.

Gjithashtu definimi i afateve kohore për krijimin e zyrave komunale, përkatësisht në goftë se vendoset të jenë zyrtarë apo zyra, të bëjnë hartimin e planeve komunale dhe funksionalizimin e sistemit të auditimit, do të ishte një domosdoshmëri.

Krejt në fund, ne i mbështesim këto rekomandime si Grup Parlamentar dhe shpresojmë se Qeveria në strategjinë legjislativë të vitit 2013, do ta përfshijë në plotësim-ndryshim edhe këtë ligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zharku e ka fjalën.

**LUTFI ZHARKU:** Faleminderit!  
I nderuar nënkryetar,  
Ministra,  
Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim i përkrah rekomandimet e Komisionit për mbikëqyrjen e Ligjit për eficiencyn e energjisë, me disa shtesa që i përmendi edhe zonja deputete Berisha, që Qeveria apo Ministria të përpilojë një strategji për përfshirjen edhe të sektorit privat dhe përfshirjen e masave të ndryshme që kanë të bëjnë me stimulimin e institucioneve publike, po natyrisht edhe të sektorit privat për rritjen e eficiencys së energjisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pjesë nga raporti të cilin e kemi paraqitur për votim sot dhe për diskutim, tashmë u përmendën, të gjitha këto çështje, pra janë ato që kanë dalë nga koha sa jemi marrë si komision, por edhe si grup punues me monitorimin e zbatimit të ligjit për eficiencyn e energjisë. Natyrisht se të gjitha këto probleme apo mangësi, të them ashtu, në zbatimin e këtij ligji, janë të rëndësishme po veçanërisht janë paraqitur gjatë të gjitha diskutimeve dhe vizitave që i kemi pasur janë paraqitur dy si më të rëndësishmet dhe kjo ka qenë, domethënë, njëfarë mënyre një mungesë e definimit të qartë të kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal për sa i përket zbatimit të pjesëve të caktuara të ligjit apo të eficiencys së energjisë dhe në anën tjetër çështja e fondeve, pra çështja e buxhetit për ta realizuar një plan përmes të cilit do të sigurohej një përdorim më eficient i energjisë në sektorin e energjisë, por edhe atë ekonomik në Kosovë.

Natyrisht se çështja e eficiencys së energjisë është një çështje shumë e rëndësishme dhe kjo po bëhet për çdo ditë e më e rëndësishme për shkak të dimensionit që ajo e ka, që nuk është vetëm dimensionin ekonomik, por është edhe dimensionin shoqëror, pastaj edhe dimensionin mjedisor. Pra, të gjitha këto ndërthuren në këtë logjikën e përdorimit më eficient të energjisë, gjë që edhe për Kosovën është shumë e rëndësishme për të gjitha këto arsye dhe duke marrë parasysh faktin se në çfarë shtate energjetike gjendet sot Kosova dhe cila do të ishte kjo shtatë në të ardhmen sipas planit të Qeverisë, por edhe sipas asaj që do të duhej të ndodhte në sektorin e energjisë në Kosovë në mënyrë që jo vetëm të investojmë në prodhimin, në rritjen e prodhimit të energjisë, por të investojmë edhe në një përdorim më të kujdesshëm të energjisë në mënyrë që të kemi përdorim më të matur të resurseve tona dhe të kapaciteteve energjetike që i kemi dhe do t'i ndërtojmë.

Edhe kur është miratuar ligji për eficiencyn e energjisë, Grupi ynë Parlamentar e ka ngritur çështjen e një fondi të veçantë, i cili do të ishte fond stimulues për masat e eficiencys së energjisë që do t'u jepej qytetarëve, qoftë në sektorin privat, por gjithsesi edhe në sektorin publik në mënyrë që të gjitha ato masa të mbrojtjes apo të rritjes së përdorimit më efikas të energjisë që do të zbatoheshin nëpër objektet që ndërtohen në Kosovë dhe do ta përmirësonin dukshëm këtë gjendje.

Dhe gjatë monitorimit, siç e përmenda dhe siç u përmend edhe nga dy deputetët parafolës që kanë qenë pjesë të grupit punues, pra nga zoti Zharku dhe nga zonja Berisha, një prej çështjeve kryesore që është paraqitur si problem, të them ashtu, në këtë fushë, ka qenë

mungesa e fondeve. Thjesht, në njërin anë nuk kemi fond të veçantë që do të merrej me stimulimin e përdorimit më eficient të energjisë, ndërkohë në anën tjetër edhe kur ndahet në buxhet nuk kemi ndarje të mjaftueshme, madje as të sigurt të fondeve për Agjencinë Kosovare për Eficiencën e Energjisë, e as për rritjen e masave stimuluese.

Kemi vërejtur që shumica, mos të them të gjitha projektet që kanë të bëjnë me eficiencën e energjisë, që janë zbatuar dhe po zbatohen në Kosovë, në pjesën dërmuese janë të financuara nga institucionet e huaja, pra, qoftë nga Komisioni Evropian qoftë nga institucionet financiare për zhvillim të jashtëm të vendeve të ndryshme të Evropës, ndërkohë që një pjesë goxha e vogël do të thosha është financiar drejtpërsëdrejti nga Qeveria e Kosovës dhe rrjedhimisht njëra prej rekomandimeve thotë ose e fton Qeverinë që ta rrisë interesimin dhe ta rrisë investimin në këtë fushë, për shkak se këto pastaj do të sjellin dobi të shumta për Kosovën e për qytetarët e Kosovës dhe ekonominë e Kosovës, në përgjithësi.

Pra, një fond i veçantë, ne konsiderojmë, si Grup Parlamentar do të duhej të ishte i domosdoshëm për këtë fushë për shkak se është dëshmuar edhe nëpër vendet tjera, veçanërisht në vendet e Evropës, siç është shembull Gjermania dhe vendet tjera, që fondi stimuluese ka qenë arsyeja kryesore pse është rritur interesimi për eficiencën e energjisë në sektorin privat, qoftë në shtëpi, e po ashtu edhe në objekte afariste dhe kjo mendojmë se do të duhej të ndodhte edhe në Kosovë, në mënyrë që të kemi një sukses më të madh në këtë sektor.

Dhe, për fund, është edhe çështja e përfshirjes së sektorit privat, që është e domosdoshme të përfshihet me ligj, pavarësisht rrethanave në të cilat jetojmë, ne mendojmë se për ta pasur një zbatim sa më të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës të logjikës së eficiencës së energjisë, duhet domosdoshmërisht mos ta përjashtojmë asnjë sektor nga obligimet ligjore që dalin për këtë sektor dhe në këtë drejtim përfshirja në ligj me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të sektori privat është e domosdoshme.

Dhe çështja e tretë, është pikërisht kjo ndarja e kompetencave dhe definimi i qartë i asaj se çka do të duhej të bëjë komuna dhe si do të duhej ta bëjnë kuvendet komunale, domethënë t'i përmbushin përgjegjësitë që i kanë karshi këtij sektori për shkak se në ligj thuhet shumë qartë, pra në ligjin aktual, se është përgjegjësi e komunave që përveç që ta kenë zyrën komunale për eficiencë energjie po ashtu edhe të hartojnë plane komunale për eficiencë energjie dhe në këtë drejtim, me sa e kemi vërejtur ne gjatë monitorimit, asnjëra prej komunave në Kosovë nuk ka as zyre e as plan të tillë. Dhe, në diskutimet që e kemi pasur me Agjencinë për Eficiencën e Energjisë na është thënë se për shkak të mungesës së fondeve ata po mendojnë që të fillojnë me një ndryshim të parimeve ligjore për sa i përket kësaj çështjeje dhe të fillojnë me zyra rajonale në vend të zyrave komunale, gjë që është në shpërputhje pastaj me ligjin. Pra, në ndryshim-plotësimin e Ligjit për eficiencën e energjisë duhet të vendoset nëse zyrat komunale janë të pamundshme për shkak të mungesës së fondeve, atëherë që të vendoset me ligj që të ketë zyra rajonale dhe në këtë drejtim që të fillojë puna në përpilimin dhe zbatimin e planeve komunale për eficiencën e energjisë.

Përkundër të gjitha këtyre që i thashë, natyrisht Lëvizja “Vetëvendosje” do t’i përkrahë këto rekomandime dhe e ftojme Ministrinë përmes Qeverisë që sa më shpejt të fillojë procesin e ndryshim-plotësimi të ligjit për shkak se nga ky ligj pastaj do të varet edhe rishkrimi apo rihartimi i planit në nivel të Kosovës për efikasitet të energjisë dhe nga kjo pastaj do të varen natyrisht edhe vendimet tjera që do të merren në sektorin e energjisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, kryetarja Selmani e ka fjalën.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh se ne sot po diskutojmë për raportin e monitorimit të Ligjit për efikasitetin e energjisë elektrike, do të ishte e udhës që ministri i Zhvillimit Ekonomik të ishte i pranishëm, për arsye se ka mangësi në këtë projektligj dhe është ndihmë edhe e tij po edhe jona që të ndihmojmë në zbatimin e projektligjit.

Komisioni parlamentar në bazë të Rregullores së Kuvendit ka për obligim edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për efikasitetin e energjisë, ku shihet se në bazë të ligjit, Ministria e Zhvillimit ka themeluar Agjencinë e Kosovës për Efikasitetin e Energjisë, ku edhe komplet Ligji i efikasitetit të energjisë parasheh vetëm formimin e kësaj agjencie, dhe jo diçka tjetër.

Në rast se e shohim punën e Grupit punues gjatë monitorimit të Ligjit, mund të themi se Ministria deri më tani ka nxjerrë disa akte nënligjore, mirëpo në esencë mungojnë akoma aktet tjera të cilat kishin mund t’i japin hapësirë pak më të madhe këtij ligji për arsye se në efekt ligji është vetëm çështja e formimit të Agjencisë Kosovare për Efikasitetin e Energjisë, mirëpo ligji në tërësi është shumë i zbrastë.

Në rast se i shohim punimet, të cilat i ka realizuar Grupi Punues gjatë vizitave në terren dhe shqyrtimi të dhënave, ka arritur t’i identifikojë shumë probleme, siç janë mungesa e legjislacionit sekondar, mungesa e rregullativave ligjore në sektorin privat, mosthemelimi i zyrove komunale, mirëpo te zyrat komunale duhet të kemi një kujdes për arsye se ata kanë pasur mundësi në bazë të Ligjit të vetëqeverisjes lokale të kenë nga një zyrtarë të efikasitetit të energjisë elektrike për arsye se nëse kanë inxhinierë aty ata kanë pasur mundësinë të kenë atë inxhinierë edhe për këtë aspekt për arsye se dihet se buxheti nuk mundëson që të formojmë zyra për secilin sektor veç e veç.

Mos përfshirja e sektorit privat, për këtë arsye them se ligji është i zbrastë ku shihet mjaftë mirë se ligji nuk e parasheh apo e rregullon sektorin privat dhe është kjo një kompetencë në të cilën do të kishte pasur mundësi implementimin e masave të efikasitetit.

Fatbardhësisht në rekomandim thuhet se Qeveria obligohet të bëjë plotësim- ndryshimin e ligjit. Një numër i madh i akteve nënligjore të cilat i referohen ligjit jep hapësirë ad hoc

apo hapësirë ditore implementimit të këtij ligjit dhe prapëseprapë vijnë te rekomandimi i parë ku i thuhet Qeverisë të bëjë plotësim- ndryshimin e ligjit.

Dhe ligji ka mungesa në dispozita sanksionuese, do të thotë që në efekt në rast se e marrim komplet ligjin dhe komplet punën të cilën e ka bërë Komisioni Parlamentar dhe grupi punues për monitorimin e zbatimit të ligjit, atëherë duhet shumë qartë të thuhet se ne duhet të kemi një ligj të ri me të cilën mund të japim hapësirë edhe Agjencisë të Kosovës për Efiçencën e Energjisë Elektrike edhe sektorit privat, por njëkohësisht që të kemi një praktikë të mirë edhe te qytetarët për zbatimin e efiçencës së energjisë elektrike.

Në tërësi Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re përkrah rekomandimet por edhe një herë potencoj që ministri është dashur të jetë sot këtu që së bashku me të të nxjerrim në të ardhmen një ligj shumë më të mirë me këto rekomandime.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

Në sall janë 73 deputetë.

Zotërinj deputetë, ju lus të përgatitemi për votim.

Votojmë tani.

Faleminderit! Me 70 vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim, Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit numër 04/L-016 për efiçencë të energjisë.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

## **6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Radhën e diskutuesve. E kemi përfaqësuesin e Qeverisë. Zoti ministër e keni fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar,

I nderuari ministër,

Deputetë të nderuar,

Për arsye se periudha kalimtare e lirimit të produkteve nga TVSH-ja si dhe për aktivitetet e caktuara pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme përfundon më 31 dhjetor 2012, Ministria e Financave ka bërë vlerësimin e efekteve ekonomike, sociale dhe buxhetore me qëllim të dhënies së propozimit për zgjatjen e kësaj politike fiskale, të miratuar në Qeveri kohë më parë.

Si rrjedhojë duke u bazuar në ligjin numër 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, propozohet zgjatja e periudhës kalimtare prej 1 janarit 2013 deri më 31 dhjetor 2014 për lirim nga pagesat e TVSH-së për importin dhe furnizimin e mallrave që janë të liruara nga pagesa e TVSH-së, siç janë.

- Një mori lëndësh të para dhe makineri bujqësore, të cilat janë të listuar në aneksin 4 të Ligjit mbi TVSH-n si dhe sistemi i ujitjes së tokave bujqësore,

- Furnizimi i mallrave ose shërbimeve të financuara nga paratë e grave të donatorëve në mbështetje të projekteve humanitare të rindërtimit dhe integrimeve evropiane,

- Furnizimet e mallrave dhe shërbimet e bëra për Kombet e Bashkuara, Bankën Botërore dhe organizata ndërkombëtare ndërqeveritare,

Njëkohësisht propozohet zgjatja e periudhës kalimtare prej 1 janar 2013 deri më 31 dhjetor 2014, për aktivitetet e caktuara, pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme, neni 27 dhe 64, paragrafi 3 të Ligjit mbi TVSH-në siç janë:

- Furnizimi me shërbime dentare,

- Furnizimet e shërbimeve nga grupet e pavarura të personave që zhvillojnë aktivitetet e liruara nga TVSH-ja për anëtarët brenda atij grupi,

- Furnizimi i stafit nga institucionet religjioze dhe filozofike për qëllime mjekësore të mirëqenies sociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe për qëllime edukative,

- Furnizime të shërbimeve për anëtarë të organizatave joqeveritare si dhe, si kthim për abonimin e tyre,

- Furnizimin e shërbimeve nga OJQ-të për sport ose edukatë fizike dhe aktivitetet për ritjen e fondeve në relacion me to.

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në atë që u tha më lart, rekomandojmë që këto lejime duhet të vazhdojnë me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sektorit të bujqësisë si sektor i rëndësishëm i ekonomisë së vendit tonë.

Duke marrë parasysh kapacitetet që ekzistojnë për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore në Kosovë, fal këtij potenciali efektet pozitive për ekonominë do të jenë të mëdha dhe do të ndikojnë në zvogëlimin e papunësisë si dhe në përmirësimin e mirëqenies sociale.

Po ashtu rekomandojmë që edhe dispozitat e TVSH-së që mundësojnë lirim nga pagesa e TVSH-së për asistencën nga donatorët, të lejohet që të vazhdojë si dhe vazhdimi i periudhës transitore për aktivitetet pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së së zbritshme, siç është referuar në nenin 64, paragrafi 3 të Ligjit mbi TVSH-në. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zonja Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 64, paragrafi 2 të Ligjin numër 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar, periudha kalimtare për lirimet nga TVSH-ja fillon më 1 janar 2010 dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit 2012.

Kjo periudhë kalimtare mund të zgjatet ose të shkurtohet me propozimin e bërë nga ministri i Financave i cili aprovohet nga Kuvendi.

Ky propozim duhet të përfshijë vlerësimin e efekteve buxhetore ekonomike, sociale të implementimit ose mos implementimit të dispozitave në fjalë.

Kështu që Ministria e Financave përmes Qeverisë ka propozuar Kuvendit zgjatjen e periudhës kalimtare për lirimet nga TVSH-ja nga 1 janari 2013 deri në dhjetor 2014, për një numër të lëndëve të para bujqësore siç është paraparë në nenin 29.2 që i referohet importimit të mallrave të listuara në aneksin 4 të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Është propozuar zgjatja periudhës kalimtare për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga paratë e grandeve të donatorëve në mbështetje të projekteve humanitare, rindërtuese dhe integritimeve evropiane të parapara me nenin 30.2 si dhe lirimet për furnizimet dhe mallrat për agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërkombëtare, ndërqeveritare në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, siç është përcaktuar në nenin 33.3 të këtij ligji.

Po ashtu propozohet edhe zgjatja e periudhës kalimtare për aktivitete të caktuara pa të drejtën e zbritjes së TVSH-së për furnizim me shërbime të parapara me nenin 27, paragrafi 4, 5, 10 11, 12 të Ligjit për TVSH-në.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2012 e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për zgjatjen e periudhës kalimtare për lirimet nga TVSH-ja deri në dhjetor të vitit 2014 dhe ka vlerësuar se janë dhënë arsyetimet e nevojshme për ndikimet e efekteve buxhetore, ekonomike e sociale të implementimit të dispozitave të lartpërmendura për periudhën e caktuar dhe si i tillë propozim-vendimi përmbush kriteret ligjore të parapara me nenin 64.2 të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Komisioni njëkohësisht ka kërkuar nga Ministria e Financave të dërgojë një shkresë plotësuese që qartëson më mirë ligjërisht Propozim-vendimin e Qeverisë për zgjatjen e periudhës kalimtare për lirimet nga TVSH-ja, i cili i është bashkangjitur rekomandimit të Komisionit.

Ne rekomandojmë që të miratohet në emër të Komisionit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Krasniqi e ka fjalën.

**HASIME KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014, është një propozim-vendim për t'u mbështetur duke marrë parasysh se bën zgjatjen e periudhës kalimtare për lirimet, për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për sektorët e ndryshëm të financuara nga paratë e grandeve të donatorëve në mbështetje të projekteve për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë, që është një mbështetje për prodhuesit vendorë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që do të ndikojë edhe në punësime të reja në këtë sektor.

Po ashtu ky propozim-vendim është në mbështetje për projektet humanitare, rindërtuese dhe të integrimi evropiane.

Njëherit me këtë propozim-vendim edhe sektori i shëndetësisë gjen mbështetje të vazhdueshme, konkretisht në shërbimet mjekësore të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve.

Duke pasur të gjitha këto që janë në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet këtë propozim-vendim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

LDK-ja e përkrah Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

Pas që jemi duke biseduar për këtë pikë ne gjithashtu shfrytëzojmë rastin që t'i bëjmë thirrje Ministrisë së Financave, që të punojë nëpër shkallëzimin e TVSH-së, sepse nuk është aspak e drejtë që qytetarët e Kosovës, 45% të papunë dhe 325 mijë të varfër të paguajnë 16% TVSH për produkte të domosdoshme për jetë.

Ne gjithashtu kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të punojë në strategjinë për mbledhjen e tatimeve, do të thotë që të orientohet Qeveria në mbledhjen e tatimeve brenda dhe të mos e mbledh TVSH-n në kufij sepse kjo po paraqet barrierë shumë serioze për bizneset, sidomos ato që janë në sektorin e prodhimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosjes", zonja Fetoshi.



ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!  
Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” e mbështet këtë propozim-vendim!  
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Lama, më falni zoti Gjini u paraqit, s’ ishte i paraqitur. Zoti Gjini në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit!  
Shumë shkurt edhe ne si Grup Parlamentar e mbështesim propozim-vendimin.  
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!  
Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah vendimin e Qeverisë.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+” zonja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!  
Parlamentarna grupa “6+” podržava produžavanje prelaznog perioda oslobođanja poreza na dodatu vrednost do 31. decembra 2014. godine. Glavni cilj ove aktivnosti razvoj poljoprivrednog sektora odnosno poljoprivrednog zemljišta sa kojem je Kosovo najbogatije.

Ovim potezom se pospešuje njegov razvoj, kao i mogućnost stvaranja komparativne prednosti u poljoprivrednim proizvodima u upoređenju sa susjednim zemljama i time poboljšati negativni trgovinski bilans kako i smanjiti nezaposlenost. Takođe je važno i zbog podržavanja podrške projektima financiranih od donatorskih grantova i zbog toga Parlamentarna grupa “6+” podržava ovaj zakon. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. E ka fjalën zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!  
Realisht edhe Grupi Parlamentar u deklarua se ne jemi për vazhdimin e periudhës kalimtare për lirimin nga TVSH-ja, por unë mendoj që është dashur të jetë një vlerësim i efekteve buxhetore më konkret dhe atyre ekonomike dhe sociale në implementimin e kësaj dispozite kalimtare.

Këtë po e them për një arsye sepse arsyeja e lirimit nga TVSH-ja që ka qenë para dy vjetëve ka qenë me të vetmin qëllim që t’i krijojë favore sektorit të bujqësisë.

Ndërsa, realisht nga tabelat që janë paraqitur apo nga tabelat e mangëta që janë paraqitur, ne kemi vetëm efekte buxhetore që janë zero dhe nuk kemi asgjë në praktikë e cila ka deklaruar apo deklaron që kemi zhvillim konkret në këtë lëmi përpos fushave të caktuara.

Prandaj, duke humbur nga 7,8 milionë për çdo vit, ashtu siç është paraparë nga të hyrat buxhetore, në anën tjetër ne nuk kemi një deklaratë financiare se cili është potenciali i të hyrave buxhetore apo cili është zhvillimi efikas në këtë sektor të bujqësisë nga absorbimi i një numri të konsiderueshëm të lirimit nga TVSH-ja te makinerive të ndryshme apo pjesëve sipas kodeve të tyre.

Prandaj, kjo vërejtje duhet të jetë shumë parimore për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë, sepse ne shumë lehtë mund të deklarohejmë që jemi për lirim nga TVSH-ja në sektorë të ndryshme, por kemi mos zhvillim ekonomik dhe sidomos te sektorët më të ndjeshëm sektorit të bujqësisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Në sallë janë 65 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tani.

Konstatohet që me 58 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi vendimin për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

E kemi pikën e shtatë të rendit:

## **7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

Paraprakisht desha që t'ju njoftoj që në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, Grupi Parlamentar i LDK-së ka kërkuar që në orën 13:00 të jepet pauza, desha të ju pyes a të fillojmë?

Ta fillojmë, nuk e di a mund ta kryejmë deri në orën 13:00. Këtu është problemi, juve s'ju prishë punë. Atëherë po vazhdojmë pra.

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendi i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë si propozues të çështjes nuk ka dikush që e ka kërkuar fjalën. Kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

E kanë bërë këta propozimin me shkrim, Komisioni flet, çka kam të bëj, ne e detyrë të votojmë për ose kundër. S'kemi tjetër pikë, kjo është e fundit, pika e fundit e rendit të ditës është. Zoti Pajaziti, e keni fjalën.

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, zoti kryesues, nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër,  
Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 nëntor pasi e shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, vendosi me shumicë votash që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin me qëllim të miratimit të këtij propozim-vendimit të Qeverisë.

Më lejoni po ashtu t'ju informoj se gjatë trajtimit të këtij propozimi të Qeverisë, në Komision ka pasur debat dhe është arritur si të thuash që të votohet me një kusht, që CIV-it e disa prej anëtarëve të plotësohen në ndërkohë me qenë se kemi kërkuar, unë personalisht kam kërkuar të votohet duke pasur parasysh që kemi një vonesë jashtëzakonisht të madhe për emërimin e këtyre anëtarëve të bordit, duke pasur parasysh po ashtu disa valë të privatizimit mbeten për t'u ratifikuar ose t'u legjitimua nga bordi i cili tashmë nuk është funksional. Pra, rrjedhimisht vendit tonë i shkaktohen edhe humbje edhe atyre që kanë blerë ose kanë arritur të blejnë në këtë kohë sa nuk ka funksionuar bordi. Dhe ky ka qenë qëllimi që ne e kemi hedhur në votim, por megjithatë ka qenë një vendim i Komisionit, dëshiroj të jem korrekt ndaj gjithë anëtarëve të Komisionit, ka qenë një vendim, një qëndrim i të gjithëve që në ndërkohë të plotësohet lista e këtyre anëtarëve me CIV-it me informatat shtesë të cilat ju mungojnë. Dhe, rrjedhimisht, kjo nuk ka ndodhur në ndërkohë, pra mendojë që grupet parlamentare të vendosin vetë se çka të bëjnë.

Dëshiroj po ashtu të mos e marrë fjalën dy herë edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, me qenë se ne e kemi prezantuar qëndrimin e Komisionit në grupin parlamentar. Është një vendim i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, me qenë se nuk janë plotësua këto CIV, me qenë se nuk janë në ndërkohë nuk kanë arritur informatat shtesë për këta kandidat, të mos aprovohet sot dhe rrjedhimisht të kërkohet nga Qeveria që sa më shpejtë të plotësohen emrat ose CIV-it e tyre me informatat shtesë të cilat duhet t'i kenë të gjithë deputetët në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po më vjen keq, por është dashur ndoshta në fillim të seancës me mocion për ta kërkuar këtë, sidoqoftë unë po e marr si mocion edhe të Grupit Parlamentar të PDK-së me qëllim që të shtyhet kjo për një seancë tjetër me kushtin që të plotësohen dosjet. Ky është mendimi i Grupit Parlamentar të PDK-së. Nga LDK-ja, fjalën e ka Ismet Beqiri.

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj që propozimi i Komisionit është shumë i qartë, e çka thotë Grupi Parlamentar i PDK-së tash është tjetër çështje kjo. Ne konsiderojmë se për këtë është dhe është propozimi i Qeverisë, ka shkuar në Komision, ka ardhur në Kuvend dhe Kuvendi duhet të votojë.

Unë po e them qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, sepse kjo që kërkon tash Grupi Parlamentar i PDK-së është dashur me herët të plotësohet e jo të vijë në seancë.

Ne nuk e përkrahim, gjegjësisht do të votojmë kundër këtij propozimi për këta kandidat-, anëtarë të bordit, mes tjerash janë disa arsye, por arsyeja kryesore është që ky bord është i

politizuar e kemi thanë shumë të qartë edhe në paraqitjet tona edhe sot po e themi. Ndërkaq, nga vetë zoti Thaçi këtu në seancë më 2 tetor është thënë që ne si Qeveri nuk do të politizojmë bordin në këtë rast Agjencisë Kosovare për Privatizim dhe në propozim ndodhë e kundërta, sepse pa keqkuptim mund të kenë përgatitje njerëz e të tjera, por këtu e kemi propozimin për vetë kryesuesin që është eksponent, anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së ish-zëvendësministër dhe po ashtu edhe kandidat për deputet të gjitha këto, prandaj këtu s'ka të bëjë me kurrfarë pavarësie të agjencisë në këtë rast.

Prandaj, ne edhe për arsye sigurisht dosjeve, mos kompletimit dhe mendojmë mungesës së përvojës nga ajo që kemi parë, ne si Grup Parlamentar i LDK-së do të votojmë kundër këtij propozimi.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” konsideron që kjo listë e cila na është paraqitur me kandidatë për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është e papranueshme, për shumë arsye që u thanë këtu, por edhe për disa arsye tjera. Pra, përveç çështjes që është një listë e cila për ata eksponentë që njihen si eksponent të partisë në pushtet pra të Partisë Demokratike të Kosovës, me përjashtim natyrisht të zotit Haxhi Arifi, i cili është kryetar i Sindikatës dhe rrjedhimisht këtë post në Bordin e AKP-së e ka si rrjedhojë pra e ka ex officio.

Ndërkohë që për sa u përket këtyre emrave tjerë ata as nuk njihen e as nuk kanë ndonjë informatë të theksuar për ta vlerësuar nëse është idenë për të qenë në këtë bord apo jo, pra ironikisht vetëm përfaqësuesi që ka qenë zëvendësministër, ai ka dhënë edhe më së shumti informata për punën e tij, përvojën, shkollimin e kështu me radhë. Ndërkohë, që këta të tjerët disa janë shumë të rinj si për shembull siç është kjo zonja Maja Milanoviq, e cila mendoj që është jashtëzakonisht e re për të pasur, domethënë përvojën e mjaftueshme për të shërbyer në një bord kaq të rëndësishëm, për shkak se këtu po pajtohemi të gjithë që ky bord është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe vendimet e këtij bordi kanë pasoja të mëdha për atë se çfarë ndodhë në ekonominë e vendit siç e kemi pa deri tash që ka pasur dhe duke qenë se rëndësia e këtij bordi është kaq e madhe, atëherë kujdesi për anëtarë të bordit duhet të jetë shumë i madh nga të gjitha institucionet. Këtu e kemi parë në shkujdesje të vrazhdë të Qeverisë përse i përket emrave të propozuar dhe një diçka që i mungon, domethënë këtyre CV-ve, këtyre rezymeve të dorëzuara nga këta kandidatë e që nuk është vetëm rasti te këta, por te të gjithë që na vijnë këtu në Kuvend, është se nuk kemi madje as dy reshta të shkruar nga vetë kandidatët për atë se pse mendojnë ata se do të jenë të mirë për këtë bord në të cilin po kandidohen dhe çfarë mendojnë ata të bëjnë me këtë vend të tyre të punës? Pra, si mendojnë këta persona që na janë ofruar këtu se do t'i përmirësojnë punët edhe çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ne e kemi këtu një agjenci e cila tash e sa kohë është duke u kritikuar dhe duke u shikuar me sy të dyshimtë nga të gjithë qytetarët e Kosovës, po veçanërisht nga ata punëtorë të Kosovës, pasurinë e së cilëve kjo agjenci e ka shitur dhe madje nuk ua ka dhënë as 20%

dhe tash kemi një diskutim për disa anëtarë për bordin e kësaj agjencie të cilët nuk na thonë as edhe një fjalë të vetme se çfarë e kanë ndërmend të bëjnë me këtë bord.

Pra, nuk mjafton për poste të tilla që të kemi vetëm CV-të e njerëzve, pra të na tregojnë personat, kandidatët se çfarë kanë punuar, ku janë shkolluar e kështu me radhë, po duhet domosdoshmërisht që ata ta japin një lloj zotimi para Kuvendit se në mandatin tim unë do ta kryej këtë dhe këtë, këtë, punë dhe mënyra si do t'i kryej ato punë. Pra, kjo i mundëson secili deputetë që ta ketë informatën e mjaftueshme nëse do ta voton një person apo ajo. Mënyrën siç e kemi këtu, kjo është fatkeqësisht po e them e pa mundshme për ta bërë një vlerësim dhe rrjedhimisht këtë listë të kandidatëve Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë kundër.

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Zoti Grabovci e ka kërkuar fjalën për një çështje, në emër të Grupit.

**ADEM GRABOVCI:** Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike bërë një mocion, prandaj unë kërkoj që të hidhet në votim ky mocion dhe pastaj ne të procedojmë më tutje, është e drejtë e jona që të kërkojmë një gjë të tillë. Dhe arsyetimi i kryetarit të Komisionit ishte shumë i qartë. Arsyet pse po kërkojmë janë biografite e paplotësuara le të plotësohen pastaj i marrim në shqyrtim dhe i shohim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Në rregull, do ta hedh në votim, por e kanë të drejtën kryetarët e grupeve parlamentare të shprehen.

Nga AAK- ja zoti Gjini e ka fjalën.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se ashtu siç thatë edhe ju, ka qenë dashur që kryetari i Komisionit ose përfaqësuesi i Qeverisë në fillim të seancës të na tregoj se nuk janë plotësuar kushtet sipas Komisionit që Kuvendi të votojë sot për këtë listë.

Mendoj se praktikisht do të ishte jo në rregull që ne të votojmë, qoftë për, qoftë kundër emrave të njerëzve për të cilët nuk kemi marrë as biografi, as CV, që mendoj se kjo duhet të kompletohet dhe të bëhet në seancën e parë të radhës sa më shpejtë të jetë e mundshme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Selmani, kryetarja e Grupit e ka fjalën.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke marrë parasysh kërkesat që i tregoi edhe kryetari i Komisionit Parlamentar për çështjen e biografive të këtyre anëtarëve të bordit, tash është krejt me vonesë ata është dashur kaheër t'i sjellim përpara se të dalin emrat e tyre në seancë. Ndërsa edhe kësaj radhe vendimi i Qeverisë është shumë i vonshëm dhe na vë para aktit të kryer duke ditë se Bordi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit është dashur më herët të kompletohet dhe çdo vonesë e votimit të këtij bordi sjell pasoja dhe e dimë mjaftë mirë të gjithë këtu si

deputetë të këtij Kuvendi të Kosovës, çfarë reputacioni ka tash për tash Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, zonja Kostić.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem gospodine predsedavajući!  
Parlamentarna grupa Samostalne liberalne strane podržace predlog predsednike Komisije i mi smatramo da se ovo pitanje treba tretirati na nekoj od narednih sednica. Zahvaljujem!

KRYESUESI: “6+”, nuk dëshiron. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën, mendoj që në emër të Grupit është folur, megjithatë fol.

*(Ndërhyrje: Po, a kemi të drejtë ne si deputetë?)*

Në rregull, por para votimit është lidhur me mocionin. Atëherë më lejoni që ta nxjerr në votim mocionin e Grupit Parlamentar të PDK-së që kjo pikë e rendit të ditës të mos shqyrtohet sot me arsyetimin që e dha Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, gjegjësisht kryetari i Komisionit, zoti Zenun Pajaziti.

Përgatitemi për votim. Në sallë janë 81 deputetë. Votojmë tash.

Faleminderit! Me 46 vota për, 34 kundër dhe një abstenim miratohet mocioni i Grupit Parlamentar të PDK-së që çështja në fjalë pra zgjedhja e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të shtyhet sipas kërkesave që ka bërë Komisioni FunkSIONAL.

E kemi edhe një pikë të rendit të ditës:

### **8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar që deputeti Imri Ahmeti të emërohet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Armend Zemaj. Nuk është askush kundër. Është vetëm njoftim. Faleminderit! Miratohet. Seanca është kryer.

Mirupafshim në seancat e ardhshme!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*